



PLANI PËR INTEGRITET

Komuna e Gjilanit

2015-2017

PËRMBAJTJA

FALENDERIME	3
DEKLARATA E INTEGRITETIT	4
PLANI I INTEGRITETIT	6
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, LINJAT E AKTIVITETIT DHE MASAT	8
<i>Objektiva Strategjike 1</i>	9
<i>Objektiva Strategjike 2</i>	13
<i>Objektiva Strategjike 3</i>	29
<i>Objektiva Strategjike 4</i>	33
PLANI I VEPRIMIT	36



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

MIRËNJOHJE

Grupi punues i Komunës së Gjilanit:

- Lutfi Haziri, Kryetar i Komunës
- Nazim Gagica, Drejtor në Drejtorinë e Administratës
- Valon Shefkiu, Drejtor i Urbanizmit
- Sali Kqiku, Drejtor i Zyrës së Prokurimit
- Ismajl Januzi, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
- Ilmi Limoni, Drejtor për Financa
- Nazmi Musa, Drejtor i Arsimit
- Halit Rexhepi, Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim

Dokumenti është hartuar me mbështetje nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Ekipi i Projektit të UNDP-së Mbështetje përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK).

Plani i Integritetit për Komunën e Gjilanin (2015) është përgatitur dhe publikuar me ndihmën bujare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Ndërsa është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Kjo deklaratë ka për qëllim që të ofrojë një deklaratë gjithëpërfshirëse që tregon qartas politikën tona specifike, procedurat dhe masat operative në lidhje me integritetin, etikën, transparencën dhe llogaridhënien.

Ne, në Komunën e Gjilanit kemi traditë të mirësjelljes etike përgjatë gjithë historisë sonë. Ne besojmë që kemi mandat të veçantë dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme që e tejkalojnë atë të një autoriteti të rëndomtë lokal.

Ne kujdesemi për Qytetin e Gjilanit në emër të mbi 90,015 banorëve të tij që jetojnë këtu, si dhe në emër të shumë të tjerëve që punojnë këtu dhe që vizitojnë këtë vend. Ne përpiqemi të ofrojmë shërbime moderne, efikase dhe cilësore për më shumë se 3,000 biznese private të regjistruara që operojnë në komunë. Ne mbështesim dhe promovojmë këtë Qytet si qendër administrative të Rajonit të Gjilanit në Kosovë dhe kujdesemi për rigjenerimin ekonomik në zonat përreth. Ne gjithashtu jemi punëdhënës kyç lokal me përgjegjësi që shtrihen tek mbi 8,500 persona.

Ne integrojmë misionin tonë me përgjegjësitë tona. Sa më gjithëpërfshirëse, të rëndësishme dhe komplekse që bëhen përgjegjësitë tona, paraqiten më shumë mundësi për sjellje keqpërdoruese dhe korruptive. Zyrtarët komunal gëzojnë kompetenca të konsiderueshme deskreacionale dhe monopol mbi shërbimet publike, si zhvillimin ekonomik lokal, shëndetësinë, arsimin, banimin, tokën, ujërat, etj. Ndërveprimet më të afërta në momentin e dhënies së shërbimit mund të nxisin mundësi të shumta për korrupsion. Ndërveprimi i pakontrolluar me grupet e interesit të autoriteteve lokale dhe partitë politike në nivel lokal mund të ndikojë konsiderueshëm në integritetin profesional dhe të nxisë vendime të njëanshme. Nepotizmi dhe favorizimi në komunitetet lokale mund të paraqesë sfida për cilindo vendim-marrës në të gjitha nivelet e shërbimit. Përveç mundësive dhe rreziqeve nga korrupsioni, korniza normative si dhe aplikimi i saj mund të kenë ngecje në konsistencë dhe fokusim, dhe kështu të lehtësojnë edhe më tej shkeljet potenciale të integritetit. Procedurat e rënda administrative paraqesin një kërcënim shtesë për shërbime efektive dhe efikase. Mungesa e ndërveprimit efikas dhe e reagimeve nga palët tona të interesit dhe klientët e shërbimeve tona mund të na parandalojnë nga marrja në kohë e masave të duhura korrigjuese. E gjitha kjo jo vetëm që mund të sjellë humbje financiare, por mund të prekë rëndë dhe negativisht kredibilitetin tonë si organizatë. Riparimi i dëmeve, duke përfshirë humbjet e besimit mund jetë e vështirë për t'u kompensuar.

Duke marrë në konsideratë të mësipërmet, ne kuptojmë plotësisht mandatin tonë për të luftuar korrupsionin në nivel lokal. Integriteti është zgjedhja jonë me dashje, si individë ashtu edhe si organizatë për t'iu përmbajtur standardeve etike dhe profesionale, dhe për të vepruar në pajtueshmëri me rregullat dhe rregulloret e aplikueshme, normat, kulturën, vlerat dhe standardet etike të rregulluara me ligj dhe vlera të shoqërisë. Ne si komunë aspirojmë për një nivel më të lartë të përkushtimit nëpër të gjithë organizatën dhe në çdo nivel, drejt përmirësimit të nivelit të integritetit nëpër të gjitha shërbimet publike në kryerjen e detyrave të veta si një qeveri llogaridhënëse, që operon në pajtueshmëri me politikën e saj të integritetit dhe me parimet e qeverisjes së mirë.

Në këtë mënyrë ne jemi të vendosur që:

- Të veprojmë në çdo moment me nder dhe integritet dhe në mënyrë transparente që do lejojë prej së afërmi analizën detajuar publike; obligim ky që mund të tejkalojë veprimin thjeshtë në kuadër të ligjit.
- Të nxisim dhe implementojmë këtë të fundit dhe frymën e të gjitha politikave dhe procedurave komunale.
- Të mos përdorim asnjëherë rolin zyrtar komunal, si dhe qasjen e besuar në resurset publike, duke përfshirë qasjen në informata, për përfitime personale për ne apo të tjerët, apo për qëllime të avancimit në detyrë, apo keqpërdorimin e kohës publike në ndjekje të objektivave të tilla.
- Të marrim në vazhdimësi të gjithë hapat e mundshëm për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive të tyre zyrtare dhe çështjeve të tyre private në të mirë të interesit publik.
- Të përmbahemi nga përfshirja në çfarëdo biznesi apo transaksioni apo nga të pasurit e çfarëdo interesi financiar apo interesi tjetër personal, që është apo mund të dalë të jetë në përpjeshmëri me kryerjen e detyrave zyrtare.
- Të shmangim nepotizmin dhe favorizimin në përmbushjen e detyrave zyrtare.
- Të aplikojmë hapur politikën “zero tolerancë” ndaj korrupsionit; të hetojmë si duhet të gjitha shkeljet e zbuluara të integritetit, dhe atëherë kur është e nevojshme, të nisim veprimet e duhura kundër atyre që janë përgjegjës.
- Të përmirësojmë konsiderueshëm politikat tona parandaluese të korrupsionit duke avancuar praktikat tona menaxhuese për të siguruar fokusim drejt konsumatorit, efektshmëri dhe efikasitet të operimeve, si dhe të jemi menaxhment efikas i integritetit që bazohet në risk që eliminon apo dukshëm redukton mundësitë për sjellje keqpërdoruese.
- Të përkrahim zhvillimin e shërbimit publik të trajnuar mirë, të ndershëm, të respektuar, të paanshëm e të strukturuar që është i rrënjosur në parimet e integritetit, që është në gjendje që profesionalisht të shërbejë dhe të përmbushë nevojat si edhe pritjet e qytetarëve dhe bizneseve tona.
- Të përmbahemi nga çfarëdo sjellje që mund të humbë vlerën e imazhit të integritetit apo profesionalizmit të Komunës së Gjilanit.

Deklarata jonë e integritetit është përkthyer në masa operative në këtë Plan të Integritetit. Ne besojmë që ky është një hap thelbësor dhe ne do të bëjmë të gjitha që kërkohen për të siguruar që masat implementohen, rreziqet rivlerësohen periodikisht dhe që marrja e rrezikut të integritetit e bazuar në informata bëhet pjesë e kulturës organizative e Komunës së Gjilanit.

Unë, nëpërmjet këtij dokumenti, shprehë përkrahjen time të plotë dhe të pakusht dhe përkushtimin tim të prerë për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit në kuadër të Komunës së Gjilanit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit

Lutfi Haziri

PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është dokument strategjik, si dhe operacional që është rezultat i procesit të vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë në Komunën e Gjilanit. Ky Plan tregon përkushtimin e Komunës për përmirësimin e mëtejshëm të kontrolleve ekzistuese operacionale në spektrin e plotë të aktiviteteve të realizuara, me fokus në ofrimin e shërbimeve transparente, efikase dhe të orientuara kah klienti. Ai përcakton masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të saj të integritetit dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe vlerave dhe standardeve profesionale.

Ky Plan do të luajë rol vendimtar për Komunën e Gjilanit që

- Të mundësojë menaxhimin e rrezikut të integritetit në mbarë organizatën me fokus strategjik në fushat me rrezikshmëri të lartë; të balancojë menaxhimin proaktiv me atë reaktiv të menaxhimit të rrezikut të integritetit; të zvogëlojë/eliminohet mundësitë për korrupsion dhe të përmirësojë rimëkëmbshmërinë e përgjithshme ndaj korrupsionit;
- Të fuqizojë përputhshmërinë me kërkesat përkatëse ligjore dhe procedurale dhe standardet kryesore ndërkombëtare të menaxhimit;
- Të zhvillojë më tej kapacitetet e të gjithë personelit për parandalim efektiv të integritetit dhe zbulimin e cenueshmërive, të ngrijë vetëdijen tek të gjitha nivelet dhe funksionet, të inkurajojë përkushtimin kolektiv dhe bashkë-pronësinë në menaxhimin e integritetit;
- Të avancojë kornizën e mirëbesimit me palët e jashtme dhe të brendshme të interesit, dhe t'i përgjigjet kërkesave dhe pritjeve të tyre në lidhje me performancën e integritetit të Komunës.

Plani bazohet në rezultatet e procesit gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të rrezikut të kryer në Komunën e Gjilanit, që është iniciuar në nëntor 2014 dhe është kryer në shtator-tetor 2015. Ky proces ka përfshirë identifikimin e cenueshmërive organizative ndaj shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë në konsideratë (1) dëmin në aspektin material dhe jomaterial që shkeljet potenciale përkatëse shkaktojnë dhe (2) mundësinë që ngjarjet e tilla mund të ndodhin, e parë përmes rezistencës organizative aktuale të mbështetur në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat përkatëse dhe përfshirjen e personelit. Për të përmbushur pikat e sipërpërmendura, Komuna ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- Janë caktuar përgjegjësitë për planifikimin e integritetit duke themeluar Grupin Punues të udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Gjilanit;
- Është hulumtuar korniza strategjike, rregullative dhe operacionale relevante me Komunën;
- Janë analizuar të dhëna nga performanca, monitorimi dhe implementimi i integritetit;
- Janë analizuar kënaqshmëria e klientëve dhe perceptimi i korrupsionit në sektorin e qeverisë lokale, duke përfshirë studimet/raportet e kryera nga organizatat ndërkombëtare;
- Është proceduar studimi/vetëvlerësimi referues organizativ për të ofruar informata dhe të dhëna të vlefshme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në Komunë; bazuar në rezultate, janë identifikuar fushat me rrezikshmëri dhe linjat e masat operacionale për përmirësim (është zhvilluar vetëvlerësimi i sistemit të integritetit të organizatës);

- Janë përdorur punëtori me grupe fokusimi dhe tabela të veçanta të përpunuara për rrezikut për të adresuar rreziqet specifike në njësitë kyçe administrative dhe fushat me rrezikshmëri të lartë për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e integritetit dhe listuar masat për përmirësim (punëtorja është mbajtur; është zhvilluar Regjistri i Rrezikut të Integritetit);

- Janë përdorur dokumentet/udhëzimet që lidhet me zhvillimin e integritetit të UNDP-së, Konspektet e Praktikave më të Mira të Integritetit, doracak të Transparency International, standardet e menaxhimit të rrezikut ISO 31000 dhe FERMA, Specifikacioni BS 10500 për sistemin e menaxhimit kundër mitosjes; standardi Australian/Zelandës së Re kundër korrupsionit – AS 8001-2008; Udhëzimi ISO 26000 për përgjegjësinë shoqërore; Parimet e Punës së Transparency International për luftimin e mitosjes; Kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 dhe Menaxhimi i Sigurimit të Informacionit ISO 27001; si referencë për të mbështetur masat e propozuara.

Një buxhet i veçantë për implementimin e këtij Plani do të ndahet sipas Planit të Veprimit të hartuar dhe bashkëngjitur (Shtojca 1). Komuna do të mundësojë monitorimin periodik të strukturuar të implementimit të tij për të siguruar që masat e kontrollimit të rrezikut të integritetit dhe trajtimit janë efikase si në kuptimin e projektimit ashtu edhe të operimit; që procedurat janë kuptuar dhe që plani i integritetit është respektuar. Përgjegjësitë për monitorimin e rregullt të Planit i janë caktuar _____. Raportimi i rregullt do të sigurojë që implementimi i Planit të bëhet sipas planit dhe që të arrihen rezultatet e planifikuara. _____ do të jetë përgjegjës për të raportuar në baza periodike te Kryetari i Komunës lidhur me implementimin. Shpeshtësia minimale e raportimit është në periudhën gjashtë mujore. Raportimi i mundëson Kryetarit që të ndërmarrë me kohë masat korigjuese/parandaluese në rast se zbatimi i ndonjë mase/masave të caktuara paraqet vështirësi/vonesa.

Në veçanti Plani i Integritetit duhet të përmbajë:

- **Deklaratën e Integritetit** e cila rithekson përkushtimin për integritet të Komunës së Gjilanit.

- **Planin e Integritetit** – shpjegon historikun, fushëveprimin, qëllimin, objektivat dhe metodologjinë.

- **Objektivat strategjike, linjat e aktiviteteve dhe masat** përcaktojnë objektivat kyçe strategjike dhe fushat e veprimit që synojnë fuqizimin e mbrojtjes së integritetit në Komunën e Gjilanit. Këto bazohen në rreziqet e vlerësuara të integritetit, mësimet e nxjerra dhe praktikrat e mira përkatëse. Plani ofron arsyetim/justifikim për linjat e aktiviteteve të planifikuara, të mbështetura më tej me masa të synuara për të drejtuar implementimin.

- **Planin e Veprimit** që përcakton në hollësi të gjitha masat që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e caktuara, si dhe kornizën kohore përkatëse dhe përgjegjësitë organizative për implementim. Janë definuar indikatorët e suksesit për secilën masë, të mbështetura me resurset e nevojshme /shifrat financiare.

Plani i Integritetit shihet si baza strategjike për të përmirësuar më tej *sistemin e menaxhimit të integritetit në Komunën e Gjilanit (më tutje në dokument SMI)*. Sistemi i tillë konsiderohet si çelës në reduktimin e kostove të konsiderueshme ekonomike dhe njerëzore të shkeljeve të integritetit, në avancimin e biznesit të ardhshëm dhe rritjen e reputacionit dhe kredibilitetit të organizatës. Planifikimi i integritetit mbetet shtylla e tij themelore.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, LINJAT E AKTIVITETIT DHE MASAT

Komuna e Gjilanit aktualisht është duke kaluar nëpër një proces të modernizimit të thellë. Duke u mbështetur në arritjet e veta deri më tani dhe e inspiruar nga agjenda kombëtare kundër korrupsionit dhe praktikave të suksesshme ndërkombëtare, Administrata duhet që më tej të avancojë praktikave të saja të menaxhimit të integritetit duke u fokusuar në katër fushat thelbësore në vijim:

- **Rregullimi i qeverisjes:** fuqizimi i kornizës së politikave dhe institucionale për menaxhim efikas të rrezikut të integritetit;
- **Rregullimi i praktikave të menaxhimit të rrezikut:** avancimi i kontrolleve operacionale për fushat specifike të operimit me rrezikshmëri të lartë;
- **Rregullimi i resurseve:** sigurimi i kapaciteteve të duhura dhe të përshtatshme të personelit për të udhëhequr, implementuar, monitoruar dhe përforcuar reformat e integritetit;
- **Rregullimi i mjedisit:** avancimi i mjedisit të jashtëm për të përforcuar dhe zgjeruar aspektet e integritetit në proceset e modernizimit dhe reformave me procese të përmirësuara të koordinimit dhe komunikimit, si dhe duke mbajtur nivele të larta të transparencës dhe angazhim të palëve të interesit.

Në vijim paraqiten dhe shpjegohen objektivat e sipërpërmendura strategjike dhe këto objektiva përkthehen në linja të aktiviteteve konkrete të politikave dhe menaxhimit dhe në masa që përkrahin arritjen e tyre.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1:

Rregullimi i qeverisjes: fuqizimi i kornizës së politikave dhe institucionale për menaxhim efikas të rrezikut të integritetit;

Linjat e aktiviteteve dhe masat përkatëse

1.1. Zhvillimi i mëtutjeshëm i sistemit të menaxhimit të integritetit të bazuar në rrezik (politikave, rregullave dhe praktikave) si pjesë thelbësore e të gjithë sistemit të menaxhimit organizativ.

Arsyetimi: Komuna e Gjilanit, ngjashëm si komunat tjera në Kosovë, ballafaqohet me rreziqe të konsiderueshme të integritetit. Ato paraqiten për shkak të faktorëve të brendshëm (p.sh. i atribuohen diskrecionit të ushtruar të gjerë, ofrimit kompleks të shërbimeve, kornizës normative, institucionale dhe operative të gjerë dhe nganjëherë jokohërente, kontrolleve të mangëta, ndikimit politik, kapaciteteve dhe infrastrukturës mbështetëse joadekuate, etj.) si dhe për shkak të faktorëve të jashtëm (p.sh. legjislacioni dhe standardet e reja dhe në zhvillim dinamik, pritjet në ndryshim të palëve të interesit, interesat kundërshtues, presioni nga palët e interesuara, etj.). Në këtë kontekst, për të identifikuar, vlerësuar dhe zvogëluar rreziqet ekzistuese të integritetit, komuna ka implementuar vlerësimin e rrezikut të integritetit dhe ka përpiluar këtë Plan Integriteti. Sidoqoftë, ky Plan si i vetëm nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur shumë çështje serioze lidhur me integritetin dhe korrupsionin. Për të arritur rezultate të qëndrueshme, komuna duhet të zhvillojë/fuqizojë sistemin mbështetës të menaxhimit të integritetit. Kjo kërkon (1) planifikimin e politikave/masave të saj të integritetit; (2) implementimin e planit dhe kontrolleve të ndërlidhura operative; (3) kontrollin: monitorimin dhe matjen e karakteristikave kyçe të operimeve që përcaktojnë performancën e integritetit; dhe (4) ndërmarrjen e veprimeve për të përmirësuar vazhdimisht performancën e integritetit dhe sistemin e menaxhimit të integritetit. Edhe pse sistemi i menaxhimit të integritetit nuk mund të ofrojë siguri absolute që nuk ka pasur apo nuk do të ketë korrupsion sa i përket Administratës, mund t'i ndihmojë komunës në parandalimin dhe detektimin e praktikave keqbërëse. Ai demonstroi që Komuna e Gjilanit ka implementuar masa të arsyeshme dhe proporcionale për të ndihmuar atë në përmbushjen e obligimeve të saj ligjore dhe aspiratave etike.

MASAT

1.1.1. Përmes implementimit/aktualizimit të politikës së integritetit dhe planit të integritetit, zbatimi i një strategjie të integruar për parandalim dhe kontrollim të integritetit për të siguruar një bilanc të duhur ndërmjet zhvillimit të kulturës etike organizative të bazuar në vlera dhe zbatim-it të kontrolleve të fuqishme, duke pranuar që asnjëra nuk duhet ndjekur duke përjashtuar tjetrën.

1.1.2. Sigurimi që i gjithë personeli të jenë të dijeni për Politikën e Integritetit dhe

Planin e Integritetit, duke përfshirë masat, përgjegjësitë dhe afatet kohore përkatëse. Të konsiderojë komunikimin e Planit tek Kuvendi Komunal dhe Komitetet. Nëse është e përshtatshme, të konsiderohet komunikimi i Planit apo pjesëve të tij tek palët kyçe të interesit.

1.1.3. Zhvillimi i strukturës pronësie në menaxhim të integritetit dhe parandalim e kontrollim të korrupsionit nga niveli më i lartë i organizatës deri në atë më të ulët. Kjo kërkon ndarjen e qartë dhe eksplicite të

përgjegjësive dhe autoriteteve të ndërlidhura për funksionin e përmbushjes së integritetit në komunë, duke përfshirë përgjegjësinë dhe autoritetin për mbikëqyrjen e implementimit të Planit të Integritetit dhe raportimit që lidhet me të.

1.1.4. Marrjen në konsideratë të një vargu resursesh shtesë si linjën e këshillave falas apo këshillimin etik për të ndihmuar personelin në vendim-marrje etike. Për të funksionuar me efikasitet, instrumenteve të tilla u nevojitet format i strukturuar, me procedura dhe autorizim përkatës të aprovuara. Duhet futur masa të veçanta për të mbrojtur konfidencialitetin. I gjithë personeli duhet informuar në mënyrë periodike lidhur me mekanizmat e përcaktuar në mënyrë që ata të mund t'iu referohen atyre kur është e nevojshme. Funkzioni i këshillimit për integritet duhet të ketë personel të cilët kanë kompetencat, kredibilitetin, statusin dhe autoritetin e duhur.

1.1.5. Përveç rregullores ekzistuese ligjore për dhuratat, kërkimin që personeli të regjistrojë të dhënat për të gjitha dhuratat, përfitimet dhe mirëpritjet e ofruara, në mënyrë që komuna të mund të monitorojë qasjet e jashtme. Përmes trajnimeve të rregullta dhe ngjarjeve sensibilizuese, të arrihet që i gjithë personeli të kuptojë obligimet e veta ligjore sa i përket dhuratave. Të mbahet Regjistri i Dhuratave i kërkuar me ligj i Komunës së Gjilanit dhe të sigurohet që i gjithë personeli është në dijeni për ekzistencën e tij.

1.1.6. Shqyrtimin e rregulloreve të brendshme ekzistuese për KI-në për të identifikuar nevojën për avancimin e tyre të mëtutjeshëm në mënyrë që të arrihet mbulueshmëri e plotë e çështjeve që kanë të bëjnë me integritetin. Sigurimin që i gjithë personeli është i familjarizuar mirë me rregullat për KI dhe procedurat e që lidhen me të. Marrja në konsideratë e testimin në intervale të planifikuara kohore i të kuptuarit të Konfliktit të Interesit nga personeli.

1.1.7. Zhvillimi i sistemeve të për-

shtatshme të informimit dhe komunikimit në lidhje me menaxhimin e integritetit duke përfshirë: atë se çfarë do të komunikojë; kur të komunikojë; me kë të komunikojë; si të komunikojë. Mbledhja dhe analiza e të dhënave kthyesë lidhur me funksionin e këtij sistemi për të përmirësuar efikasitetin e tij.

1.1.8. Shqyrtimi i mekanizmave raportues për t'i mundësuar personelit dhe publikut që t'i bëjnë me dije udhëheqësisë së komunës dyshimet për korrupsion. Investimi dhe promovimi me efikasitet i mekanizmave raportues si linjat anonime për ankesa nga palë të treta. Zbatimi i politikave për Informatorë dhe/apo Linja Integriteti për pranimin e raporteve për keqbërje të rënda. Sigurimi i raportimit konfidencial i shkëlqejve të integritetit, përveç rregulloreve përkatëse kombëtare, përcaktimi i procedurave për informues e cila duhet ndjekur në mënyrë që të raportohen çfarëdo raste të mashtrimit dhe/ose korrupsionit. Sigurimi i komunikimit periodik të saj tek i gjithë personeli, për të mbështetur të kuptuarit koherent, qëndrimet pozitive dhe zbatimin efektiv.

1.1.9. Promovimi i auditimeve dhe kontrolleve tjera të personelit si një mundësi për të mësuar e përmirësuar e jo për si ushtrim ndëshkimi. Planifikimi/kryerja e testeve të sistemeve: d.m.th. operimet e fshehta të klientëve, auditimet ad hoc, për të testuar rimëkëmbshmërinë dhe për të identifikuar mangësitë e mundshme në sistem. Menaxhimi efikas i rrezikut kërkon efikasitet të kontrolleve të aplikuara, duke përfshirë aplikimin dhe shqyrtimin e tyre. Ofrimin e këshillimit dhe udhëzimit lidhur me kontrollet e brendshme për të parandaluar mashtrimet apo korrupsionin. Shqyrtimet e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së kontrolleve të brendshme dhe masave për përputhshmëri. Të raportohet për statusin e strategjisë për kontrollin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit tek udhëheqësia komunale.

1.1.10. Mbajtja e aftësive të brendshme hetuese duke përfshirë hetues të kualifikuar dhe udhëzues të aktualizuar për he-time. Ofrimin e trajnimit të specializuar për teknikat hetuese në zbulimin e korrupsionit për personelin përkatës. Ofrimin e ekspertizës speciale të jashtme hetuese kur shihet e nevojshme.

1.1.11. Monitorimi i implementimit të kodit të etikës në komunë duke aplikuar kriteret e miratuara. Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për personat përgjegjës për të monitoruar parimet e etikës dhe transparencës në komunë.

1.1.12. Mbajtja e bazës të dhënash për rastet e mashtrimit apo korrupsionit dhe të ofrojë analizë të trendeve për udhëheqësinë komunalë për të identifikuar veprimin e hershëm. Rishikimi i kontrolleve të brendshme pas zbulimit të rastit të mashtrimit apo korrupsionit. Kontrollimi për aplikim të vazhdueshëm të procedurave disiplinore për rastet e detektuara,

dokumentimi dhe komunikimi i këtyre kontrolleve. Raportimi dhe publikimi i trendeve na baza vjetore.

1.1.13. Promovimi aktiv i politikave për menaxhimin e rrezikut të integritetit përmes komunës. Sigurimi i ri-vlerësimit të Rreziqeve të Integritetit, d.m.th. në fund të periudhës së planifikimit, dhe/ose pas shqyrtimeve të aktiviteteve të njësive me funksione kontrolluese në fushat me nivel të lartë të rrezikshmërisë. Shqyrtimi periodik dhe aktualizimi i planit të integritetit për zgjidhjen e mungesave në cilëndo nga këto masa parandaluese.

1.1.14. Sigurimi që rreziqet strategjike të integritetit janë në agjendë për takime periodike të menaxhmentit të lartë. Shqyrtimi i rregullt i kornizës së integritetit që mbështetë kulturën e integritetit dhe mos tolerimin e mashtrimit apo korrupsionit. Raportimi i brendshëm i rezultateve dhe përshkallëzimi atëherë kur është e përshtatshme.

1.2. Fuqizimi i praktikave të përgjithshme të menaxhimit, duke përfunduar menaxhimin e cilësisë dhe të informatave, fokusimin drejt konsumatorit, transparencën, proceset efektive dhe efikase, për të kufizuar mundësitë për shkelje të integritetit dhe për të optimizuar performancën e integritetit

Arsyetimi: SMI-ja nuk operon në vakuum, por është e lidhur ngushtë me mënyrën se si komuna menaxhon aspekte të rëndësishme deri te ato të integritetit siç janë ofrimi i shërbimeve cilësore dhe siguria e informacionit. Duke marrë në konsideratë natyrën holistike të sistemit të menaxhimit komunal, standardet më të larta të performancës së integritetit janë në korrelacion të drejtpërdrejt me cilësinë, llogaridhënien, transparencën, efektshmërinë dhe efikasitetin e operimeve. Kështu, përveç SMI-së në operim, mund të aplikohen edhe instrumente tjera, duke u bazuar në parimet e njëjta TQM, d.m.th./cikli P-D-C-A. Këto përfshijnë ndër të tjera shqyrtime funksionale, ISO 9001, ISO 27001, CAF, EFQM, Kartat për Shërbimet për Qytetarë, etj. Përputhshmëria me standarde ndërkombëtare do të ofrojë një kornizë të brendshme operative të fokusuar në cilësi dhe integritet. Shqetësimi adekuat lidhur me sfidat për sigurimin e informacionit do të kufizojë me efikasitet mundësitë për shkelje të integritetit në këtë fushë. Qasja e integruar do të mundësojë përdorim më eficient të resurseve dhe do të mundësojë planifikim të integruar. Pranimi përmes certifikimit (ISO 9001 dhe/ose ISO 27001) apo regjistrimi dhe verifikimi (CAF dhe EQFM) ofrojnë stimulime dhe shpërblime shtesë. Kartat për Qytetarë transmetojnë mesazh të fuqishëm tek klientët e brendshëm dhe ata të jashtëm për përkushtim të qartë të menaxhmentit për integritet dhe për shërbim transparent dhe të orientuar drejt klientit.

MASAT

1.2.1. Marrja në konsideratë e mundësive për të planifikuar/implementuar shqyrtim funksional të administratës komunale për të eksploruar mundësitë për rritje të efektshmërisë dhe efikasitetit të proceseve, shmangien e funksioneve/përgjegjësive të dyfishta, mundësitë për rritje të koordinimit dhe llogaridhënies.

1.2.2. Shqyrtimi i organizimit të komunës dhe sigurimi që Organogrami në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbulon pozitat dhe linjat përkatëse të përgjegjësive dhe llogaridhënies për të arritur transparencë maksimale dhe efikasitet të operimeve.

1.2.3. Rritja e efikasitetit dhe llogaridhënies, miratimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës dhe sistematizimin e tyre bazuar në Katalogun e Vendeve të Punës të miratuar nga qeveria. Vazhdimi i rregullimit të pozitive të punës me përgjegjësitë që dalin nga rregullorja e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në institucione dhe me modelin e përcaktuar me katalogun për vende pune.

1.2.4. Planifikimi/implementimi i përpjekjes së strukturuar drejt zhvillimit të sistemit të menaxhimit të bazuar në procese që efektshëm mund të promovojë shërbime cilësore dhe eficiente. Për këtë qëllim, identifikimi i procesve kyçe strategjike, operationale dhe mbështetëse, listimi i tyre në Regjistrin e procesve komunale dhe shqyrtimi se sa mirë janë të mbuluara me procedura të brendshme. Aty ku ka mangësi, marrja në konsideratë e zhvillimit të procedurave të tilla për të zvogëluar rrezikun nga gabimet, devijimet dhe shkeljet e integritetit. Komunikimi i këtyre procedurave tek i gjithë personeli i përfshirë. Trajnimi i personelit nëse është e nevojshme.

1.2.5. Mbajtja e monitorimit të strukturuar të proceseve dhe implementimit të strukturuar të procedurave, duke konsideruar gjithashtu futjen e indikatorëve matës të performancës. Personeli i organizuar i trajnuar si duhet dhe dokumentimi i rezultateve që është edhe i integruar në proceset e vendim-marrjes.

1.2.6. Përveç Organogramit, Rregullores mbi organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe procedurat operative, rishikimi i përshkrimeve ekzistuese të vendeve të punës. Kontrollimi periodik nëse ato janë në përputhshmëri me proceset faktike dhe aktet përkatëse, sigurimi që ato janë në harmoni dhe që komunikohen tek personeli përkatës.

1.2.7. Vazhdimi i përpjekjeve drejt zhvillimit të sistemit dhe kulturës së dhënies së shërbimeve publike miqësore me përdoruesin. Fuqizimi i fokusimit ndaj konsumatorit, demonstrimi i përkushtimit për standarde profesionale të shërbimit dhe maksimizimi i mundësive për mbikëqyrje qytetare, marrja në konsideratë e zhvillimit/implementimit të veglës për menaxhim të bazuar në TQM. Bazuar në vlerësimin e realizueshmërisë, marrja në konsideratë e implementimit të një apo më shumë instrumenteve të dëshmuara për të maksimizuar efektshmërinë dhe eficientë në ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë ISO 9001:2015, Kornizën e Përbashkët të Vlerësimit, skemën e përsosmërisë EFQM, Kartat e Shërbimeve për Klientë, etj.

1.2.8. Krijimi i mekanizmave dhe instrumenteve për matjen sistematike të opinionit publik lidhur me cilësinë e shërbimeve që u ofrohen atyre nga administrata. Për këtë qëllim, aty ku është e realizueshme, planifikimi dhe implementimi i anketave për kënaqshmërinë e konsumatorëve; kontrollimet

ad hoc, operimet e fshehta për klientë, etj.

1.2.9. Ofrimi i hartës rrugore në futjen e sistemit mbrojtës për sigurinë e informacionit, të bazuar në standardet ndërkombëtare në dispozicion: udhëzimet OECD për Sigurinë e Informacionit dhe Rrjeteve dhe standardi për menaxhim ISO/IEC 27001. Ofrimi i resurseve për proces duke ngritur ekspertizë adekuate për menaxhimin e sigurimit të informacionit. (d.m.th. trajnime në ISO 27001 për personelin relevant). Mundësimi i deklaratës për siguri që promovon aspektet e sigurisë së informacionit në nivel strategjik; vlerësimi i rrezikut, si dhe mundësimi i kontrolleve specifike operative për të siguruar përzgjedhjen e kontrolleve adekuate dhe proporcionale të sigurisë që mbrojnë pasuritë informative.

Marrja në konsideratë e marrëveshjes për konfidencialitet, kushtet dhe termat për përdorim të kompjuterit, rinovimi i fjalëkallimit, klasifikimet, skanimi i postës së pranuar, mbajtja e auditimeve dhe raporteve për përjashtime, revokimi automatik i qasjes kur ndërpritet punësimi. Ndarja e përgjegjësive në lidhje me implementimin e saj, si dhe e resurseve përkatëse.

1.2.10. Krijimi i sistemit të organizimeve të rregullta për vetëdijësim/kanaleve për mentorim për të siguruar që personeli është sensibilizuar rregullisht për rreziqet e integritetit që lidhen me sigurinë e informacionit dhe përdorimin e resurseve kompjuterike, në veçanti – kontrollin e qasjes.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2:

Rregullimi i praktikave të menaxhimit të rrezikut: avancimi i kontrolleve operative për fushat specifike të operimit me rrezikshmëri të lartë

Linjat e aktiviteteve dhe masat përkatëse

2.1. Fuqizimi i kontrolleve operative të rrezikut të integritetit në proceset kyçe të menaxhimit dhe mbështetjes me rrezikshmëri të lartë

Kuvendi Komunal

Arsyetimi: Sistemi i menaxhimit të integritetit në Komunën e Gjilanit operon në lidhje të ngushtë me Kuvendin Komunal të zgjedhur drejtpërdrejt që është organi më i lartë në kontekstin komunal. Përveç LLSG dhe Statutit të Komunës, vendimet kyçe strategjike në fushat e rëndësisë së lartë me rrezikshmëri të lartë janë në kuadër të kontrollit të drejtpërdrejt nga Kuvendi: d.m.th. miratimi i buxhetit dhe planeve të investimeve; niveli i taksave komunale, tarifave dhe ngarkesave; vendimet lidhur me pronën komunale; miratimin dhe amandamentimin e: Planit Zhvillimor të Komunës (PZhK); Planit Zhvillimor Urbanistik (PZhu) dhe Planit Rregullativ Urban (PRU). Për shkak të kufizimeve në llogaridhënie horizontale në rastin e Kuvendit Komunal, kufizimi i fushëveprimit të SMI-së, përgjegjësitet e tij drejt SMI-së komunale në fakt janë të kufizuara në sigurimin e përkushtimit të Komunës për të implementuar atë. Komuna si një organ ekzekutiv është përgjegjëse për sigurimin e përshtatshmërisë së SMI-së, për implementimin e tij dhe për përpunueshmërinë me të.

MASAT

2.1.1. Përveç praktikave të mira në dispozicion, promovimi i miratimit të Kodit të Etikës / Kodit të Mirësjelljes / Rregullave të Integritetit nga Kuvendi Komunal.

2.1.2. Inkurajimi i pjesëmarrësve të këshilltarëve Komunal në organizimet për vetëdijesim që lidhen me integritetin/ngjarje për MP-në, si dhe në takimet për shqyrtim të menaxhimit të integritetit në mënyrë që ata të demonstrojnë leadership në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit në kuadër të fushave të tyre të përgjegjësisë.

2.1.3. Të siguruarit që rregullat dhe procedurat e kuvendit komunal për pjesëmarrjen publike në planifikim buxhetor të implementohen efektshëm. Të siguruarit që buxheti komunal publikohet me kohë në medie.

2.1.4. Marrja në konsideratë e krijimit të komitetit, me personal nga përfaqësues të qeverisë lokale dhe me vëzhgues të pa-

varur nga OJQ-të, për të monitoruar implementimin e buxhetit rregullisht, d.m.th. çdo gjashtëmuorësh. Organizmi i debateve publike/forumeve për të informuar qytetarët lidhur me implementimin e buxhetit, publikimi i raporteve për implementimin e buxhetit, publikimi i raporteve tremujore për shpenzimet.

2.1.5. Parandalimi i KI-së dhe rritja e mbikëqyrjes qytetare, propozimi i marrjes në konsideratë të përfshirjes së përfaqësuesve të OJQ-ve, shoqatave të bizneseve, palëve tjera relevante të interesit në komitetet mbikëqyrëse për projektet e financuara nga Kuvendi Komunal.

Kabineti i Kryetarit

Arsyetimi: Njerëzit në pozita udhëheqëse përcaktojnë tonin etik të Komunës, prandaj edhe luajnë rol kyç në krijimin e integritetit organizativ dhe rezistencës ndaj korrupsionit. Është thelbësore që menaxherët mos të komunikojnë vetëm lidhur me mirësjelljen e pritur dhe vlerat e dëshiruara të personelit, ata gjithashtu duhet të demonstrojnë mirësjelljen dhe veprimin në mënyra që janë në përshtatshmëri me vlerat që komuna dëshiron t'i shoh tek i gjithë personeli. Duke udhëhequr nga pozita frontale, udhëheqësia politike mund të ndihmojë në mbjelljen e besimit më të lartë tek punëtorët për të raportuar dhe përshtatur me politikën, duke ditur që udhëheqësit e tyre do të marrin me kohë veprimet e përshtatshme për t'iu përgjigjur ankesave valide dhe për shqiptuar dënimet në rast të shkeljeve të politikave. Politikën e shkëlqyeshme të koordinimit dhe komunikimit janë kanalet për të siguruar që mesazhet nga menaxhmenti i lartë shpërndahen si duhet tek nivelet dhe funksionet relevante.

MASAT

2.1.1. Shqyrtimi i sistemeve ekzistuese të koordinimit dhe komunikimit, në krahasim me nevojat e perceptuara, praktikat më të mira dhe realizueshmëritë/kufizimet lokale, për të identifikuar mundësitë për përmirësim. Ndërmarrja e përpjekjeve të strukturuar për të formalizuar proceduar për koordinim të brendshëm vertikal dhe horizontal, si dhe koordinimin e jashtëm me kategori të ndryshme të palëve të interesit: qeverinë qendrore, komunat, bizneset, OJQ-të, etj. Atëherë kur është e përshtatshme dhe e realizueshme, krijimi/mbajtja /përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të brendshëm digjital të komunikimit duke përdorur infrastrukturën e TI-së për të mundësuar shkëmbim më efikas të të dhënave dhe komunikim nëpër të gjitha njësitë. Balancimi i veglave elektronike dhe tradicionale të koordinimit dhe komunikimit. për të ofruar stimulime dhe për të krijuar bashkë-pronësi, udhëheqësia komunale duhet të takohet rregullisht me punëtorët komunal, në mënyrë që t'i sigurojë që ata kanë rol thelbësor në komunë. Duhet inkurajuar takimet e drejtorive, e më pas ato të vazhdohen më poshtë deri tek të gjitha njësitë operative. Kjo do të sigurojë përhapjen e duhur të informacionit, duke vënë secilin në hap me aktivitetet e komunës.

2.1.2. Marrja në konsideratë e implementimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Dokumenteve dhe të Dhënave, që do të çojë në standardizimin e proceseve të mbajtjes elektronike të të dhënave nëpër komunë, do të përmirësojë ndarjen e informatave ndërmjet personelit dhe ndërmjet përdorueseve, alokimin elektronik dhe monitorimin e dokumenteve; përpunimin elektronik të kërkesave, krijimin e ndërfaqes elektronike për të marrë informata për kërkesat lidhur me statusin e dosjeve. Sistemi i tillë është aktualisht duke u zhvilluar nga qeveria, ndërkaq aplikimi i tij do të rrisë llogaridhënien, eficiencën dhe efikasitetin e proceseve, do të zvogëlojë kostot dhe do të ofrojë gjurmë të qarta për auditim.

2.1.3. Marrja në konsideratë e implementimit i regjistrimit për të regjistruar të gjitha ankesat, kërkesat e drejtpërdrejta, korrespondencën e letrave të ardhura për qëllime të përcjelljes; caktimi i zyrtarit specifik të lartë përgjegjës për monitorimin e ankesave dhe zgjidhjen e tyre. Sigurimi që rezultatet komunikohen me kohë tek ankuesi. Sigurimi i analizave periodike (dyvjetore dhe vjetore) të sinjaleve, sugjerimeve dhe ankesave, lidhur me cilësinë e shërbimeve dhe respektimin e standardeve për shërbimet e ofruara.

Sistemi i menaxhimit financiar. Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive

Arsyetimi: Kontrollat financiare janë thelbësore në sigurimin e parandalimit efektiv të shkeljeve të integritetit, humbjeve që lidhen me to dhe një varg të dëmeve tjera. Vlerësimi i kryer i rrezikut të integritetit paraqet kuptimin mirë nga personeli të cënueshmërive dhe kompleksitetit të proceseve të menaxhimit të buxhetit në komunë. Fushat me rrezikshmëri të lartë shihen si në vijim: mungesa e regjistrimit të pasurisë rezulton në shpërdorimin e pasurisë; procedimi i pagesave për kreditorët për kthim me favore; keqpërdorimi i makinave komunale për përfitime personale; procedimi i pagesave të dyfishta për furnizuesit. Për të minimizuar nivelet e ndërlidhura të rrezikut, kontrollat operative të integritetit që janë dëshmuar si efikase dhe që mund të shqyrtohen për aplikim, përfshijnë ndër të tjera: implementimin rigoroz të ndarjes së detyrave në fushat e caktuara me rrezikshmëri të lartë; nivele të duhura të autoritetit për miratim të pagesave; sigurimin që angazhimi dhe puna apo shërbimi i kryer nga i paguari janë miratuar duke përdorur mekanizmat specifik të miratimit; kërkesën për së paku dy nënshkrime për miratim të pagesave; kërkesën e dokumentacionit të duhur mbështetës që t'i bashkëngjiten miratimeve për pagesa; kufizimin e përdorimit të parave të gatshme; sigurimin që kategorizimet dhe përshkrimet e pagesave në llogari janë të sakta dhe të qarta; implementimin e shqyrtimit periodik nga menaxhmenti të transaksioneve të mëdha financiare; implementimin periodik të auditimeve financiare. Komuna, përveç rregulloreve të aplikueshme ligjore, do të tentojë që vazhdimisht të integrojë dhe implementojë kontrollat e mësipërme në procedurat dhe praktikatat e veta të brendshme të menaxhimit financiar.

MASAT

2.1.1. Mundësimi i implementimit të kornizës së brendshme publike për kontrollim financiar, që siguron që parimi i llogaridhënies menaxheriale është ngulitur mirë në praktikatat e menaxhimit. Për këtë qëllim, marrja në konsideratë e zhvillimit të procedurës/procedurave të brendshme gjithëpërfshirëse për menaxhimin e buxhetit me përshkrim të qartë të proceseve/aktiviteteve të ndërlidhura, linjat e raportimit dhe llogaridhënies. Ato duhet të jenë në harmoni me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës dhe sistematizimin e tyre dhe në rastin ideal të bazohen në shqyrtimin funksional për të përcaktuar mundësitë

ekzistuese për arritjen e nivelit më të lartë të efikasitetit dhe llogaridhënies.

2.1.2. Bazuar në shqyrtim funksional dhe kornizën ekzistuese të brendshme, ndërmarrja e përpjekjes së strukturuar për të ofruar resurse për funksionin e menaxhimit financiar duke alokuar personelin e nevojshëm (sipas numrave dhe zotësive), si dhe duke siguruar kapacitete të brendshme adekuate profesionale të personelit përmes trajnimeve të specializuara. Duke marrë në konsideratë kostot për këtë trajnim, marrja në konsideratë e përdorimit të të gjitha mundësive, duke përfshirë trajnimet e organizuara nga organet qendrore, KIPA, donatorët, etj.

2.1.3.Atëherë kur është e mundshme, puna me auditorë të jashtëm për identifikimin e mashtrimit.

2.1.4.Krijimi i sistemit të besueshëm/mekanizmit adekuat për të përcjellë shpenzimet buxhetore në intervale të planifikuara kohore (d.m.th. në baza mujore) për të mundësuar llogarimbajtje më të mirë të dinamikës së implementimit buxhetor. Monitorimi dhe bashkërendimi i të gjitha kredive në baza mujore. Analiza e raporteve kontabël për menaxhmentin për të identifikuar trendet.

2.1.5.Zhvillimi/mbajtja e regjistrit të aseteve. Organizimi i përditësimit të rregullt dhe monitorimi në baza mujore.

2.1.6.Avancimi i kontrolleve të brendshme për sistemet e shumëfishta financiare, duke përfshirë rishikimin pas transaksionit. Implementimi i analizave rutinore të të dhënave në fushat e identifikuar si thelbësisht të cenuara ndaj mashtrimit, korrupsionit dhe shkeljeve të tjera

të integritetit.

2.1.7.Mundësimi i auditimeve të rregullta dhe ad hoc për regjistrimin e pronës komunale. Rritja e kontrollit për regjistrimin e pronës duke mundësuar kontrolle ad hoc në vend për të verifikuar nëse regjistrimi është i plotë, korrekt dhe i saktë.

2.1.8.Për të minimizuar mundësitë e shkeljeve të integritetit në përdorimin e automjeteve komunale për përfitime personale, marrja në konsideratë e një apo më shumë prej masave në vijim: regjistrimi i automjeteve, përdorimi i kartelave për karburant me PIN, monitorimi i automjeteve me vlerë të lartë me GPS. Kryerja e auditimeve ad hoc për të fuqizuar respektimin e rregullave të caktuara dhe parandalimin e keqpërdorimit.

2.1.9.Dizajnimi i aranzhimeve për grante/nënkontraktim/shpenzime për të përfshirë analizën e hollësishme dhe dëshmitë për kërkesat e dorëzimit.

Prokurimi publik

Arsyetimi: Përmes procesit të dhënies së kontratave nga sektori publik, komuna dhe zyrtarët e saj janë në rrezik të jenë cak i palëve të treta që kërkojnë të korruptojnë sistemet e prokurimit për përfitime financiare. Komuna është e përkushtuar për parandalimin, identifikimin dhe luftimin e prokurimit publik. Parandalimi dhe zbulimi i parregullsive nuk është vetëm pjesë e qeverisjes së gjerë të mirë dhe e administratës publike, por është gjithashtu e domosdoshme për të mbrojtur financat publike. Rezultatet e vlerësimit të rrezikut tregojnë nivel të lartë të njohurive të personelit për kompleksitetin lidhur me mbrojtjen e integritetit në fushën e prokurimit. Kontrollat e fuqizuara operative mendohet se janë të nevojshme në fazat në vijim të proceseve të prokurimit (të renditura sipas nivelit të rrezikut): vlerësimi i tenderëve; formulimi i kriterëve të përzgjedhjes; kontrollimi për implementimin e kontratave; monitorimi financiar i implementimit të kontratës; planifikimi i për nevojat për prokurim; faza para tenderimit; përpilimi dhe publikimi i planeve/tenderëve të prokurimit; kontrollet e cilësisë së implementimit; amandamentimet e kushteve dhe termave kontraktuale në kontrata.

Masat

2.1.1. Rritja e transparencës së procedurave/praktikave të prokurimit publik. Sigurimi që informatat të jenë relevante, lehtë të qasshme dhe lehtë të përdorshme dhe në dispozicion për publikun: d.m.th. procedurat, kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit; informatat lidhur me ngjarjet që ndodhin pas dhënies së kontratës, siç është arsyetimi për dhënin e kontratës, modifikimet e kontratës. Obligimet për të reklamuar ndihmojnë transparencën dhe dekurajojnë keqpërdorimet. Monitorimi i implementimit të kërkesave për transparencë dhe raportimi periodik për to.

2.1.2. Ofrimi i resurseve adekuate për funksionin e prokurimit publik përmes ngritjes së kapaciteteve të personelit relevant, duke përdorur me efikasitet të gjitha mundësitë ekzistuese të trajnimeve. Ngritja e të kuptuarit të kërkesave teknike të Ligjit për Prokurim Publik, të kuptuar më të avancuar të natyrës dhe përdorimit të kriterëve të vlerësimit, të kuptuarit me të mirë të konceptit të vlerës më të mirë për shumën e parave dhe mënyrën se si të kontrollohet cilësia e mallrave/shërbimeve/punëve të pranuar përmes praktikave dhe procedurave të tenderimit. Të kuptuar të plotë të procedurave për mbrojtjen e të drejtave të tenderuesve dhe aplikimin e drejtë të asaj procedure në nivel komunal.

2.1.3. Mundësimi i një procesi efikas dhe eficient me resurse për përgatitjen e tenderëve kur resurset e kufizuara përdoren më së miri. Për këtë qëllim, marrja në konsideratë e standardizimit të përgjithshëm dhe përdorimi i dokumentacionit shembull për tenderë. Marrja në konsideratë e përfshirjes së kushteve kontraktuale shembull në dispozita specifike, duke përfshirë ndërprerjen e kontratës, kur ka të bëjë me korrupsion dhe çështje që ndërliken. Krijimi dhe përdorimi i bazës së të dhënave

për specifikimet në bazë elektronike për të lehtësuar përpilimin e tenderëve të ardhshëm. Kriteret uniforme pa-kosto duhet të krijohen nga ekspertët teknik dhe të verifikohen nga specialistët e prokurimit (për të siguruar që nuk eliminojnë të gjithë përveç njërit furnizues) për të mundësuar vlerësim jo-subjektiv të ofertës që siguron cilësi dhe vlerën më të mirë për shumën e parave.

2.1.4. Atëherë kur është e përshtatshme, përpilimi i tenderit, vlerësimi dhe menaxhimi i kontratës të bëhet së bashku nga departamenti i prokurimit dhe departamenti teknik përkatës për të siguruar që TeR-të janë të detajuara si duhet, por të mos inkurajohen marrëveshjet e fshehta.

2.1.5. Atëherë kur është e realizueshme, praktikimi i rotacionit të personelit në prokurim publik dhe njësinë kontraktuese për të shmangur krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve potenciale korruptive.

2.1.6. Kërkimin e deklaratave të konfliktit të interesit nga të gjithë tenderuesit, anëtarët e panelit vlerësues të tenderit dhe personeli i përfshirë në procesin e caktuar të prokurimit.

2.1.7. Zhvillimi i zinxhirëve të përgjegjësisë të përcaktuar më qartë dhe i procesit transparent në praktikën e trajtimit të tenderëve duke përcaktuar autoritetin për miratim, bazuar në ndarje të duhur të detyrave, si dhe obligimin për raportim të brendshëm. Sigurimi që funksionet në vijim trajtohen nga punëtorë të ndryshëm: rekomandimi për dhënie kontrate, lëshimi i urdhëresave për blerje, certifikimi i pranimit të mallrave dhe shërbimeve dhe verifikimi i pagesës.

2.1.8. Inkurajimi i kompanive që kanë veprimtari ekonomike me Komunën që të certifikohen se veprojnë në përputhshmëri me zotimet për integritet të Komunës dhe

kërkimi që ata të nënshkruajnë deklaratën e tillë të zotimit krahas kontratës së lidhur.

2.1.9. Konfirmimi periodik i sinqeritetit të kompanive dhe konsumatorëve të vazhdueshëm duke mbajtur bazë të dhënash/listë të zezë të furnizuesve/nënkontraktuesve që nuk kanë arritur t’iu përmbahen standardeve të brendshme të integritetit të komunës, si mjet për t’i udhëzuar vendimet e mundshme të përjashtimit.

2.1.10. Mundësimi i mbikëqyrjes së qytetarëve për prokurimin publik komunal, d.m.th. përmes shpalosjes së informatave publike të titujve të kontratave të mëdha, duke përfshirë përfaqësues nga OJQ-të dhe publikun e gjerë në monitorimin e prokurimeve me vlerë të lartë apo komplekse që bartin rreziqe të konsiderueshme për keqmenaxhim dhe korrupsion; aplikimin e kërkesës që komitetet përzgjedhëse të cilat në fakt përzgjedhin ofertën fituese, të përfaqësohen nga pjesëtarë të pushtetit lokal dhe vëzhgues të pavarur nga OJQ-të.

2.1.11. Integrimi i mekanizmave të fortë të kontrollit ndaj mashtrimit në politikat

dhe procedurat e prokurimit (p.sh. kontrollet e brendshme dhe auditimet, dhe sistemet e shqyrtimit), varësisht nga vlera, kompleksiteti dhe ndjeshmëria e prokurimit publik. Përcjellja dhe krahasimi i niveleve të porosisë nga viti në vit për të identifikuar porositë e tepërta për resurse të caktuara.

2.1.12. Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe procedurave të pagesës për kontratat e prokurimit publik.

2.1.13. Avancimi i kontrollimit të cilësisë në zbatimin e kontratave përmes intensifikimit të kontroleve ad hoc, duke përdorur komisione kur është e mundshme dhe me kërkesa më të rrepta për dokumentimin e kontroleve të cilësisë dhe pranimit të rezultateve.

2.1.14. Implementimi i treguesve të performancës së prokurimit për të monitoruar dhe përmirësuar performancën e prokurimit me kalimin e kohës: d.m.th. numrin e ankesave, kohën mes hapjes së tenderit dhe dhënies së kontratës, numrin e ndryshimeve të kontratës, rritjen e çmimeve, etj.

Auditimi i brendshëm

Arsyetimi: Auditimi mundëson shqyrtimin sistematik të proceseve dhe praktikave për identifikimin cenueshmëritë ndaj korrupsionit dhe potencialin për shkelje të integritetit. Regjimi efikas i auditimit mund të shërbejë edhe si sistem i hershëm i paralajmërimit, por edhe për të identifikuar rreziqet në zhvillim dhe mangësitë procedurale, e gjithashtu edhe si mekanizëm i zbulimit për të identifikuar rastet specifike të keqpërdorimit apo korrupsionit. Cilësia e rritur e funksionit të auditimit në Komunën e Gjilanit ndër masa të tjera, duhet të mbulojë kornizën e fuqizuar të politikave, rregulative dhe opracionale; Implementimi i auditimit të bazuar në vlerësim të rrezikut dhe sistemit të planifikuar të inspektimit (d.m.th. vlerësimi i mjedisit nga auditori i brendshëm; auditimi i sistemit të vlerësimit të rrezikut (faktorët e kritereve të rrezikut dhe metodat e vlerësimit të kritereve të rrezikut; prioritarizimi i sistemit të auditimit; strategjia e auditimit të brendshëm, etj.); personel adekuat dhe zhvillim profesional i personelit të përfshirë; procedura të rrepta të monitorimit dhe kontrole specifike të integritetit. Roli i auditimit të brendshëm dhe i kornizës për kontrollim si domosdoshmëri për një mbrojtje efektive të integritetit është kuptuar mirë nga i gjithë personeli, siç është

dëshmuar në bazë të vlerësimit të rrezikut. Kontrolli i rritur i gjetjeve të auditimit, profesionalizmi i ngritur i ekipit të auditimit, auditimet Ad hoc (të papritura/ pa planifikuara), rritja e shpeshtësisë, gjurmët e qarta të auditimit janë parë si kontrole të duhura operative për të rritur efektshmërinë e procesit të auditimit sa i përket integritetit.

MASAT

2.1.1. Ndërmarrja e përpjekjes së strukturuar për të avancuar operimin funksional dhe për të përmirësuar efektshmërinë, efikasitetin dhe transparencën e praktikave të menaxhimit të auditimit të brendshëm. Për këtë qëllim, marrja në konsideratë e implementimit të shqyrtimit funksional, për të përcaktuar mundësitë për përmirësime të procesit dhe për të përcaktuar resurset e nevojshme për të garantuar operim efikas.

2.1.2. Fuqizimi i kornizës së politikave dhe rregullative për auditimin e brendshëm. Rishikimi i procedurës ekzistuese operative, për të ofruar PSO të qartë që mbulon të gjitha fazat/hapat kyç; kërkesat për dokumentim dhe raportim; alokimin e përgjegjësive përkatëse. Adresimi i menaxhimit të rrezikut, veprimeve specifike të kontrollit, planifikimit të aluditimit të brendshëm, resurset e auditimit të brendshëm, vlerësimi i performancës së auditimit të brendshëm dhe sigurimi i cilësisë. Komunikimi i procedurave tek personeli përkatës.

2.1.3. Sigurimi i planifikimit efektiv të auditimit në baza vjetore. Në mënyrë ideale, oraret e auditimit duhen të bazohen në informata nga vlerësimi i hollësishëm i rrezikut, i cili fokusohet në rreziqet me të përhapura të mashtrimit dhe korrupsionit. Rritja e shpeshtësisë dhe shumëllojshmëria e auditimeve; rritja e përdorimit të auditimeve ad hoc (të papritura/të paplanifikuara) në baza kohore të rastësishme për të përcjellë auditimet e fundit dhe për të

verifikuar gjetjet/procedurat e përdorura. Monitorimi i implementimit të planit të aluditimit dhe mundësimi i ndërmarrjes së menjëhershme të masave korrigjuese në rast të dështimeve.

2.1.4. Rishikimi i Oraganogramit për të siguruar përputhshmërinë e tij me funksionet e kryera dhe kornizën përkatëse rregullative dhe operationale dhe harmonizimi i përshkrimeve të vendeve të punës së personelit të auditimit me procedurat e rishikuara operationale.

2.1.5. Zhvillimi i strategjisë për burime njerëzore për auditim të brendshëm që paraqet rolin thelbësor të funksionit të auditimit në sigurimin e përshtatshmërisë. Përveç kësaj, përdorimi i çfarëdo mundësie për të trajnuar personelin dhe për të rritur kapacitetet profesionale të njësisë së auditimit të brendshëm. Rritja e fushave të trajnimeve të specializuara për të përballuar me kërkesat aktuale të instrumenteve të aluditimit: kryerjen e auditimeve specifike (p.sh. – auditimet e mashtrimeve, auditimet e TI-së, auditimet e menaxhimit të cilësisë), aplikimin e procedurave të auditimit (marrjen e mostrave, intervistat, mjaftueshmërinë e dëshmimeve, etj.). Shqyrtimi i mundësive për të rritur stimulimet në punë për auditorët në sistemin aktual të shpërblimeve, d.m.th. koeficienti i punës me rrezikshmëri.

2.1.6. Atëherë kur është e mundur, inkurajimi i pjesëmarrjes së auditorëve të brendshëm në rrejetet e praktikuesve. Le-

htësimi i pjesëmarrjes së tyre në seminare relevante, konferenca dhe forume tjera për shkëmbim përvojash. Për këtë qëllim, duhet bërë caktimi i pikave të kontaktit që do të koordinojnë me ministritë qendrore, KIPA-n, donatorët lidhur me mundësitë për trajnime dhe ndërgjegjësim.

2.1.7. Atëherë kur është e mundur, implementimi i kontrolleve operacionale të integritetit: parimet e rotacionit dhe katër syve për të shmangur krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve korruptive; sigurimi i aplikimit efikas të konflikteve të interesit në proceset e auditimit për të siguruar që personeli i përzgjedhur për të kryer këto funksione nuk është me kurrfarë dyshime lidhur me integritetin. Për këtë qëllim, duhen caktuar kërkesat e qarta, duhet kërkuar deklarimin e KI-së dhe duhen kryer kontrollime të rastit lidhur me implementimin e tyre efektiv.

2.1.8. Fuqizimi i efektshmërisë së sistemit të komunikimi (rrjedha e informatave) ndërmjet njësisë së auditimit të brendshëm dhe strukturave tjera relevante të komunës. Për këtë qëllim, duhet bërë shqyrtimi i mundësive për përmirësim, duke përfshirë përdorimin e zgjeruar të teknologjive të TIK-ut dhe të përpilohet një kornizë operative për implementim me masat përkatëse, përgjegjësitë dhe afatet e

fundit.

2.1.9. Fuqizimi dhe strukturimi i kontrollit mbi zbatimin e gjetjeve/rekomandimeve të auditimit. Për këtë qëllim, të merret në konsideratë krijimi i një baze elektronike të dhënash për të përcjellë rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm dhe për të regjistruar progresin e bërë në implementim dhe do të funksionojë pikë informuese për menaxherët publik që të monitorojnë dhe vlerësojnë veprimet e kontrollit të brendshëm.

2.1.10. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për të vlerësuar cilësinë e performancës së sistemit në kohë. Monitorimi i vazhdueshëm ndodhë në vazhden e zakonshme të operimeve, dhe përfshinë aktivitetet e rregullta të menaxhimit dhe mbikëqyrjes, dhe veprimet tjera që ndërmerr personeli në kryerjen e detyrave që vlerësojnë cilësinë e performancës së sistemit të kontrollimit të brendshëm. Fushëveprimi dhe shpeshtësia e vlerësimeve të ndara varen kryesisht nga vlerësimi i rreziqeve dhe efikasiteti i procedurave të monitorimit të vazhdueshëm. Mangësitë në kontrollet e brendshme duhen raportuar në nivelet më të larta, ku çështjet serioze raportohen menjëherë të menaxhmenti.

2.2. Fuqizimi i kontrolleve operacionale të rrezikut të integritetit në fushat e operimit me rrezikshmëri të lartë

Arsyetimi: Gjatë identifikimit të nevojave për kontrolle operacionale, Komuna ka marrë në konsideratë të gjitha operacionet e saj, duke përfshirë ato që ndërlidhen me funksione të menaxhimit (p.sh. blerjen, menaxhimin financiar, etj.); dhe ato operime që ndërlidhen me procesin e operimeve çdo ditore. Vlerësimi i bërë i rrezikut thekson rreziqe të mëdha të integritetit në kontekst të funksioneve themelore të komunës në fushat: implementimi i rregulloreve për ndërtim dhe standardet për kontrollim të ndërtimit; Licencimi i shërbimeve lokale dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të zbavitjes, ushqimin, akomodimin, tregjet, shitësit

në rrugë, transportin publik lokal dhe taksitë; planifikimin urban dhe rural; përdorimin dhe zhvillimin e tokës; shëndetin publik; ofrimin dhe mbajtjen e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, shërbimet e kanalizimit, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat lokale për ngrohje; mbrojtjen e mjedisit lokal; ofrimin e shkollimit publik para fillor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, rekrutimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; banimin publik; zhvillimin lokal ekonomik. Ndër kompetenca të deleguara të Komunës që janë më të cënueshmet ndaj shkëlqeve të integritetit (që priren për raste korruptive) janë vlerësuar regjistrat kadastral; regjistrimi i votuesve; dhënia e pagesave të asistencë sociale (duke përjashtuar pensionet); dhe mbrojtja e pyjeve në territorin e komunës. Kërcënimet kryesore ndaj mbrojtjes së integritetit shihen në fushat në vijim: Blerjet/ Prokurimi/ Kontratat; menaxhimi financiar/ Përdorimi i resurseve monetare publike/keqpërdorimi dhe vjedhja; buxheti dhe menaxhimi i buxhetit; ofrimi i shërbimeve – organizimi i ofrimit të shërbimeve; pjesëmarrja në projekte; Banimi; Përdorimi i automjeteve publike. Duke u ballafaquar me sfidat e mësipërme, komuna ka identifikuar prioritetet afatshkurta dhe afatgjata dhe ka strukturuar kontrollat operationale në forma të ndryshme, siç janë shtjellimi i politikave dhe procedurave specifike relevante për të mbuluar fushat me rrezikshmëri të lartë, udhëzimet për punë, kontrollat fizike, përdorimin e personelit të trajnuar apo çfarëdo kombinimi të këtyre. Zgjedhja e metodave specifike të kontrollit varet nga një numër faktorësh, siç janë shkathtësitë dhe përvoja e personave që kryejnë operimet dhe nga kompleksiteti dhe rëndësia e integritetit të vet operacionit.

MASAT

Shërbimet publike

2.2.1. Zhvillimi në faza i Hartës Rrugore për të krijuar pikat “Të gjitha në një vend” dhe aplikimet online për shërbimet e administratës publike në harmoni me prioritetet qeveritare dhe agjendën e modernizimit. Caktimi i përgjegjësive për implementim. Tentimi për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe mobilizimi i përkushtimit nga palët lokale të interesit. Mësimi nga përvoja e të tjerëve. Ky shërbim do të rrisë efikasitetin e administratës komunale dhe do të lehtësojë qasjen në shërbime për qytetarë dhe biznese. Në kuadër të infrastrukturës teknike për Teknologjinë Informativë dhe të Komunikimit, MAP-i, respektivisht Agjencia për Shoqëri Informativë ka

ngritur një infrastrukturë të avancuar për ofrim të shërbimeve elektronike përmes Rrjetit Shtetëror i cili mbulon të gjitha zyrat e administratës shtetërore (qendrore dhe lokale) dhe Qendrës Shtetërore për të Dhëna, që redukton koston për sigurimin e resurseve harduerike për TI. Kjo infrastrukturë u shërben të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal. Komuna e Gjilanit do të përdorë këtë arkitekturë aktuale të kësaj infrastrukture si bazë për dhënie të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe për modernizimin e administratës publike.

2.2.2. Identifikimi i shërbimeve publike që ofrohen nga komuna dhe krijimi i regjistrimit të shërbimeve. Analizimi i shërbimeve

publike. Rishikimi i rrjedhës së procesit për të identifikuar mundësitë për të përmirësuar efektshmërinë, efikasitetin dhe transparencën. Rishikimi i procedurave operacionale ekzistuese për të ofruar PSO të qarta. Harmonizimi i përshkrimeve të vendeve të punës së personelit të përfshirë me procedurat e rishikuara operacionale dhe sistematizimi i vendeve të punës.

2.2.3. Përmirësimi i procesit të informimit të qytetarëve lidhur me zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve publike, lidhur me të drejtat e tyre dhe mënyrës se si mund të realizohen ato. Për këtë qëllim duhet marrë në konsideratë publikimi i listës së shërbimeve administrative, si dhe informatat e detajuara: adresa ku ofrohet shërbimi, zyrtari përgjegjës, lista e shërbimeve të dhëna, procedurat dhe kushtet, kostoja për ofrimin e shërbimit, kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit, e drejta për ankesë në rast se pranuesi i shërbimit nuk është i kënaqur me cilësinë e shërbimeve të ofruara.

2.2.4. Forcimi i kapaciteteve të personelit në dhënien e shërbimeve publike dhe procedurave administrative

2.2.5. Zhvillimi/implementimi i instrumenteve për matjen e opinionit publik lidhur me shërbimet publike komunale të dhënë lidhur me cilësinë dhe qasshmërinë në shërbime publike.

2.2.6. Minimizimi i mundësive për kontakte të drejtpërdrejta të palëve të interesuara me zyrtarët komunal dhe zbatimi i ndarjes së detyrave (vendimi përpilohet nga zyrtari profesional, ndërkaq pagesa dhe dhënia e vendimit bëhet nga një zyrtar tjetër)

Kadastrri, gjeodezia dhe asetet

2.2.7.Rishikimi i organogramit për të siguruar ligjshmëri, përputhshmëri me organizmin e brendshëm dhe kornizën rregullative, efikasitetin funksional, linja të qarta të llogaridhënies dhe obligimet përkatëse për raportim.

2.2.8.Mundësimi i analizës së hollësishme të rrjedhës së procesit në njësinë e kadastrit për të identifikuar mundësitë për përmirësime funksionale. Mbi këtë bazë, të bëhet zhvillimi i procedurës operative adekuate dhe të qartë si bazë për llogaridhënie dhe efikasitet.

2.2.9.Përcaktimi i nevojave të personelin dhe sigurimi që personeli është i trajnuar si duhet për udhëzimet apo kornizat e reja për matje kadastrale. Lehtësimi i pjesëmarrjes së personelit në takimet relevante, rrjetet e ekspertëve, konferenca,

për të inkurajuar përhapjen e praktikave të mira dhe mësimin nga përvoja.

2.2.10.Rritja e përdorimit të teknologjive moderne për të rritur efektshmërinë, efikasitetin dhe transparencën në proceset kadastrale. Atëherë kur është e mundur, zhvillimi/aplikimi i sistemit të realizueshëm të skanimit dhe arkivimit profesional.

2.2.11.Forcimi/diversifikimi i mekanizmave të kontrollit, duke përfshirë kontrollet ad hoc dhe operimet e klientëve të fshehtë. Kushtimi i rëndësisë së veçantë për fushat me rrezikshmëri të lartë: zyrat e pranimit – recepsionistët, regjistrimi dhe çregjistrimi i hipotekave, etj.

2.2.12.Marrja në konsideratë e nismës për linjë të drejtpërdrejtë të sugjerimeve për çështjet që kanë të bëjnë me kadastrin.

Inspektimet

2.1.1.Rishikimi i mundësive për përmirësimin e organizimit të funksionit të inspektimit për të rritur efikasitetin, llogaridhënien dhe transparencën dhe kështu për të avancuar rezistencën ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të integritetit. Ofrimin e analizës së hollësishme të rrjedhës së procesit, për të identifikuar mundësitë për përmirësime funksionale. Mbi këtë bazë, rishikimi i praktikave ekzistuese dhe zhvillimi i procedurës adekuate dhe të qartë operacionale si bazë për llogaridhënie dhe efikasitet. Sigurimi që ajo mbulon së paku: planifikimin e inspektimeve të bazuara në rrezik, kërkesat për dokumentim dhe raportin; alokimin e përgjegjësive përkatëse, afatet e brendshme të fundit varësisht nga rrezikut dhe rëndësia e inspektimit, menaxhimi i rrezikut, veprimet specifike të kontrollit, vlerësimi i performancës së inspektimeve dhe sigurimi i cilësisë. Sigurimi që personeli është në dijeni për këto përmes ngritjes së synuar të kapaciteteve.

2.1.2.Përditësimi i organogramit të

njësisë së inspektimit për të siguruar ligjshmëri, përputhshmëri me organizmin e brendshëm dhe kornizën rregullative, efikasitetin funksional, linja të qarta të llogaridhënies dhe obligimet përkatëse për raportim.

2.1.3.Përmirësimi në ndarjen e personelit për funksionin e inspektimit. Avancimi i profesionalizmit të personelit në teknikat specifike hetuese, bazuar në vlerësimin synuar të nevojave. Kur është e mundur, zbatimi i parimit të rotacionit dhe katër syve për të shmangur krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve korruptive; Shqyrtimi i mundësive për të rritur stimulimet në punë për auditorët në sistemin aktual të shpërblimeve, d.m.th. koeficienti i punës me rrezikshmëri.

2.1.4.Rritja e përdorimit të inspektimeve ad hoc.

2.1.5.Krijimi i sistemit të fortë të monitorimit të strukturuar të aktiviteteve të njësisë së inspektimit, duke përfshirë implementimin e planeve për inspektim, llojet e inspektimit, çështjet e hasura, trendet, etj.

Urbanizmi dhe mbrojtja e mjedisit.

2.1.6.Fuqizimi i kornizës institucionale dhe operative për operime. Rishikimi i Organogramit për të siguruar përputhshmëri me dokumentet dhe funksionet e brendshme, dhe përshkrimi i qartë i linjave të raportimit dhe llogaridhënies. Përmirësimi i mjedisit operativ duke përcaktuar procedurë të brendshme gjithëpërfshirëse/

kritere të qarta operative dhe vendim-marrëse për të zvogëluar rreziqet e lidhura të integritetit dhe për të parandaluar vendimet subjektive. Shqyrtimi i mundësisë për të zhvilluar udhëzimet operacionale që do të udhëzojnë personelin në çështje komplekse.

2.1.7. Fuqizimi i qasjes strategjike në

sistemin e planifikimit, inicimi i planifikimit afatmesëm për tu lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc. Ngritja/fuqizimi i kapaciteteve relevante të personelit bazuar në vlerësimet e nevojave për trajnime të synuara.

2.1.8. Kur është e mundshme, rishikimi/futja e mundësive për më përfshirje më aktive të qytetarëve, bizneseve, OJQ-ve dhe palëve tjera të interesit në procesin e planifikimit. Të bëhen përpjekje për të krijuar këtë përfshirje si sistem, e jo si ngjarje të rastësishme.

2.1.9. Mundësimi i rritjes së transparencës në planifikimin urban dhe rural duke marrë në konsideratë pragjet e transparencës: informatat minimale që duhen publikuar, afatet e fundit të ndërlydhura, formatet, etj.

2.1.10. Fuqizimi i monitorimit dhe kontrolleve: marrja në konsideratë e futjes së kontrolleve të veçanta për vendimet me vlerë/ndikim të lartë: d.m.th. komisionet, me pjesëmarrjen e palëve tjera të interesit; komitetet mbikëqyrëse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bizneseve dhe OJQ-ve; kontrollet ad hoc në baza të mostrave dhe auditimet përcjellëse pas nxjerrjes.

2.1.11. Diversifikimi/ fuqizimi i kanaleve për pranimin e përgjigjeve nga palët e jashtme të interesit, duke përfshirë shqetësimin për integritet dhe sugjerimet për përmirësim.

Financat, ekonomia dhe zhvillimi. Bujqësia dhe zhvillimi rural

2.1.12. Rishikimi i rrjedhës së procesit në njësinë për bujqësi për të analizuar ku janë të mbingarkuara proceset dhe mund të thjeshtësohen; Zhvillimi i procedurës adekuate së brendshme të thjeshtësuar / kritereve të qarta që adresojnë rreziqet kyçe të integritetit në sektorin bujqësor dhe parandalon vendimet subjektive; Rishikimi i Organogramit.

2.1.13. Fuqizimi i sistemit të planifikimit, inicimi i planifikimit afatmesëm për

tu lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc. Përcaktimi se cilave sektorë t'iu jepen subvencione; Planet afatmesme për të alokuar mjetet në sektorin bujqësor.

2.1.14. Sigurimin që personeli janë të trajnuar si duhet.

2.1.15. Përmirësimi i sistemit të koordinimit dhe komunikimit.

Arsimi dhe kultura

2.1.16. Rishikimi i procedurave operationale për rekrutimin e personelit në sektorin e arsimit për të siguruar kontrolle adekuate të integritetit, d.m.th. përfshirja e OJQ-ve, palëve tjera të jashtme të interesit në panelet intervistuese, rritja e transparencës së procesit të intervistimit, rritja e bërjes publike të rezultateve të përzgjedhjes.

2.1.17. Zhvillimi i procedurës së qartë/standardeve për rindërtim emergjent të

shkollave me kriterë dhe kërkesa eksplicite; rritja e transparencës në proceset e vendim-marrjes.

Përdorimi dhe zhvillimi i tokës

2.1.18. Zhvillimi i procedurës së brendshme/kritereve të duhura për adresimin e rreziqet kryesore të integritetit në procesin e përdorimit dhe zhvillimit të tokës dhe parandalojnë subjektivizmin.

2.1.19. Fuqizimi i sistemit të planifikimit, inicimi i planifikimit afatmesëm për tu lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc.

2.1.20. Fuqizimi i mekanizmave të kontrollit, d.m.th. kontrollet ad hoc në baza të mostrave dhe auditimet përcjellëse pas nxjerrjes.

Licencimi i shërbimeve lokale dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të zbavitjes, ushqimin, akomodimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin publik lokal dhe taksitë

2.1.21. Zhvillimi i procedurës së brendshme/kritereve të duhura që adreson rreziqet kryesore të integritetit në procesin e licencimit dhe parandalon vendimet subjektive.

2.1.22. Fuqizimi i mekanizmave të kontrollit, d.m.th. kontrollet ad hoc në baza të mostrave dhe auditimet përcjellëse pas nxjerrjes.

Banimi publik

2.1.23. Fuqizimi i qasjes strategjike për të krijuar një procedurë të thjeshtë për menaxhimin e banimit publik që do të minimizojë mundësitë për vendime subjektive dhe shkelje të integritetit. Futja e kritereve të qarta formale, kërkesave për transparencë, kontrollet operacionale.

2.1.24. Rishikimi/avancimi i sistemeve të kontrollit për ndërtuesit e përfshirë në rindërtimin e banimit komunal: d.m.th. dorëzimi dhe pagesa e kërkesave të kontraktuesve, kontrollet mbi cilësinë e punimeve; pagesat e kontraktuesve të

ndërtimit. Ofrimi i kërkesave të rrepta për dokumentacion. Intensifikimi i kontrolleve për përputhshmërinë me rregullat/rregulloret përkatëse.

2.1.25. Marrja në konsideratë e krijimit të mekanizimit të veçantë për reagime kthyesë për të përcjellë kënaqshmërinë me punën e kontraktuesve. Alokimi i përgjegjësive përkatëse.

Zhvillimi ekonomik

2.1.26.Rishikimi i Strukturës Organizative të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Marrja në konsideratë e mundësisë së ndarjes së infrastrukturës si sektor i veçantë përmes një vendimi nga Kuvendi. Kjo do t'i mundësojë Drejtorisë për ZHE të implementojë politikat komunale të zhvillimit të infrastrukturës dhe t'i plotësojë pozitat profesionale të personelit në sektorin e infrastrukturës.

2.1.27.Fuqizimi i sistemit të planifikimit strategjik për të krijuar një kornizë të duhur për ekonomi të qëndrueshme lokale. Avancimi i qasjes strategjike duke marrë në konsideratë përpilimin e planit strategjik global për zhvillimin ekonomik të komunës, në pikëvështrimin afatshkurtër dhe afatgjatë.

2.1.28.Ngritja e kapaciteteve të personelit për zhvillimin e politikave për zhvillim ekonomik dhe formulimin e propozimeve për masat për zhvillimin ekonomik komunal.

2.1.29.Avancimi i kontrolleve të integritetit në zhvillimin e politikave të turizmit, dhe në implementimin e tyre. Propozimi i masave për të inkurajuar sektorin privat që të përmbushë qëllimet e politikës zhvillimore të turizmit. Sipas Ligjit për Turizmin Nr. 04-L-176, nga data 11 prill 2013, hotelet dhe agjencitë e udhëtimeve do të vlerësohen në baza vullnetare, e jo në baza të detyrueshme. Kjo kërkon monitorimin e bizneseve të tilla që mund të kërkojnë më shumë përparësi sesa që u takojnë, në mënyrë që të sigurohet nivel më i lartë i përgjegjësisë dhe transparencës.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3:

Rregullimi i resurseve: sigurimi i kapaciteteve adekuate të personelit për të udhëhequr, implementuar, monitoruar dhe përforcuar reformat e integritetit

Linjat e aktiviteteve dhe masat përkatëse

3.1. Sigurimi i resurseve adekuate për menaxhim, d.m.th. kontrollimi i rreziqeve të integritetit përmes politikave të përshtatshme të punësimit dhe ngritjes në detyrë

Arsyetimi: Nëse komuna do të jetë e suksesshme në parandalimin e shkeljeve të integritetit, ajo duhet të ketë politika efikase që jo vetëm minimizojnë mundësinë e punësimit apo ngritjes në detyrë të individëve me nivel të ulët të kompetencave dhe ndershmërisë, veçanërisht në pozitat e besueshme, por edhe i motivojnë njerëzit. Secili punëtorë ka një grup unik vlerash dhe kodin personal të etikës. Kur ballafaqohen me presion të mjaftueshëm dhe një mundësi të perceptuar, punëmarrësit do të hasin në një dilemë etike. Praktikata adekuate komunale për menaxhimin e burimeve njerëzore janë të domosdoshme për mbajtjen e niveleve të larta të integritetit personal dhe institucional. Vlerësimi i rrezikut i kryer nga Komuna e Gjilanit ka treguar nivel të lartë të ndërgjegjësimit të personelit lidhur me rëndësinë thelbësore të kontrolleve adekuate operationale në proceset e MBNj-së dhe ZhBNj-së. Nëse kjo e fundit si tërësi do të ofrojë rezistencë të fortë ndaj shkeljeve të integritetit, fushat në vijim shihen se kanë nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm: atestimi dhe vlerësimi i performancës; përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit; sistemi i trajnimeve, vizitat studimore jashtë vendit, sistemi i shpërblimeve financiare, zhvillimi i karrierës. Si masa që potencialisht lidhen me integritetin e që mund të ndihmojnë në ngritjen e integritetit në proceset e përzgjedhjes dhe rekrutimit, masat në vijim konsiderohen si të përshtatshme: kriteret e qarta dhe transparente të përzgjedhjes për të parandaluar favorizimin dhe nepotizmin; procedura e brendshme e shkruar për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit; gjurmët e qarta të dokumentuara të auditimit për punën e komisioneve përzgjedhëse; kohëzgjatja e arsyeshme për përgatitjen e dokumenteve dhe dorëzimin e aplikacionit për vend pune, deklaratat për Konfliktin e Interesit të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit; kontrollimi i kualifikimeve dhe diplomave para rekrutimit. Mundësitë për përmirësim të sistemit të zhvillimit të karrierës në mënyrë që të parandalohen favorizimi, nepotizmi dhe shkeljet tjera të integritetit shihen se janë të pranishme në kontrollet operationale të integritetit në vijim: krijimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i kriterëve të qarta dhe transparente për zhvillim të karrierës; procedura të brendshme të qarta për zhvillimin e karrierës; auditimet e jashtme për procedurat e zhvillimit të karrierës, sistemi transparent i shkallës së pagesave dhe benefiteve; sistemi i ankesave i avancuar për t'iu përgjigjur me efikasitet ankesave për shpërdorim të procedurave për zhvillimin e karrierës, auditimet ad hoc lidhur me pajtueshmërinë me rregullat. Sa i përket vlerësimit, mundësitë për përmirësim të mëtutjeshëm shihen në kontrollet operationale të integritetit në vijim: procedura e brendshme e shkruar për vlerësimin e personelit; kriteret e qarta dhe transparente për të parandaluar favorizimin dhe nepotizmin; gjurmët e qarta të dokumentuara të auditimit për procesin e vlerësimit; mundësia për të marrë këshilla dhe për t'i raportuar këshilltarit për integritet lidhur me mangësitë e procesit të vlerësimit;

3.1.1. Implementimi i politikave dhe procedurave për të siguruar që kandidatët për rolet menaxhuese verifikohen për nivelin e arsimit dhe shkathtësitë e përshtatshme me rolin. Fokusimi në çështjet etike në procesin e rekrutimit dhe në kushtet dhe termat e kontratës për menaxherët e lartë.

3.1.2.

Mundësimi i implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Civil (HRIMS)- i zhvilluar dhe i menaxhuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimet Civil (MAP) dhe zgjerimi i tij tek të gjitha institucionet e administratës publike në nivel lokal. Kjo do t'i mundësojë komunës që të planifikojë dhe monitorojë implementimin e politikave në shërbimin civil. Duhet siguruar saktësia e informatave.

3.1.3.

Avancimi i rekrutimit duke përcaktuar kritere të qarta dhe gjithëpërfshirëse të testimit dhe pranimit dhe monitorim sistematik për implementimin e tyre. Kriteret e kualifikimit të kërkuara për pozitën përkatëse do të duhet të specifikojnë në tërësi fushën përkatëse të kualifikimit dhe profesionit deri në një nivel të duhur të detajimit për të shmangur diskrecionin e gjerë të komitetit të rekrutimit. Avancimi i transparencës në rekrutim duke përcaktuar standardet minimale të transparencës në rekrutim; monitorimi i rreptë dhe raportimi për implementimin.

3.1.4.

Avancimi i kërkesave për llogaridhënie për komitetet e rekrutimit dhe përzgjedhjes duke marrë në konsideratë dorëzimin e deklaratave për KI nga të gjithë anëtarët, përfshirjen e menaxherëve në linjë, vëzhguesit nga BNj-ja apo të pavarur në komitete, forcimi i kërkesave për dokumentacion: secili anëtar mban shënime

të cilat i dorëzohen BNj-së dhe ruhen në dosjen e aplikuesit; auditimi ad hoc i aktiviteteve të komisioneve të rekrutimit, etj.

3.1.5.

Implementimi i programit për kontrollimin e punësimit. Marrja në konsideratë e përdorimit të kontrollimit të detajuar për lejim (spastrim) të sigurisë dhe atij para punësimit, për kandidatët për pozita të ndjeshme me rrezikshmëri të lartë: verifikimi i punësimit të mëhershëm, i kualifikimeve dhe dosjes penale para punësimit.

3.1.6.

Mundësimi i implementimit të sistemit të ri të performancës që do të miratohet në nivel qendror. Ky sistem do të ndihmojë në lëvizje dhe avancim bazuar në kritere objektive dhe transparente dhe në merita. Mbajtja e nivelit të duhur të transparencës së operimeve të sistemit.

3.1.7.

Në proceset kryesore operationale, implementimi i sistemit të fortë për deklarimin e konfliktit të interesit nga të gjithë punëtorët dhe marrja në konsideratë e ruajtjes së centralizuar të këtyre të dhënave.

3.1.8.

Fuqizimi i kontroleve mbi menaxhimin e orarit të punës: d.m.th. marrja në konsideratë e përdorimit të sistemit për regjistrimin e kohës së punës, veprimet vëzhguese ad hoc ; sistemin e ankesave, etj.

3.1.9.

Fuqizimi i kontroleve mbi menaxhimin e udhëtimeve zyrtare; sigurimi që të gjitha udhëtimet zyrtare bëhen sipas kritereve të pranuar që janë të përcaktuara qartë, që janë publike dhe të detyrueshme me kushte.

3.1.10.

Marrja në konsideratë e inkorporimit në shqyrtimet e rregullta të per-

formancës së një vlerësimi se si ka kontribuar secili individ në krijimin e mjedisit të përshtatshëm të punës në harmoni me vlerat komunale dhe kodin e etikës.

3.1.11.

Inicimi i anketimit periodik për të monitoruar kënaqshmërinë e personalitetit me punën dhe mjedisin e integritetit si një “sistem i paralajmërimit të her-

shëm” për të zbuluar çështjet dhe trendet.

3.1.12.

Marrja në konsideratë e krijimi të linjës anonime veçanërisht për shqetësimet lidhur me rekrutimin dhe punësimin.

3.2. Zhvillimi i kapaciteteve të të gjithë personelit për të kuptuar çështjet që kanë të bëjnë me integritetin dhe për implementimin e kontrolleve dhe masave

Arsyetimi: Nëse politikat dhe lidhshipi janë blloqet bazë të ndërtimit, edukimi dhe informimi janë mjete për të siguruar që punëtorët e kuptojnë se pse është i rëndësishëm parandalimi i integritetit dhe rolin që ata e luajnë në ndihmën për komunën e tyre. Punëtorët duhen informuar dhe përkujtuar për procedurat e tyre të brendshme për identifikimin e rreziqeve, duke bërë raporte dhe në përgjithësi duke dhënë kontributin e tyre në ruajtjen e aseteve komunale, informatave dhe resurseve. Procesi i vlerësimit të rrezikut i kryer në komunë e Gjilanit ka identifikuar si mundësi për përmirësim të mëtutjeshëm kontrollet operacionale të integritetit në vijim: rritjen e transparencës për mundësitë e trajnimit, kriteret e qarta dhe transparente për përzgjedhje me konkurrencë të personave për trajnim; gjurmët e qarta të auditimit dhe raportimi i rezultateve të trajnimit; vlerësimi i efektshmërisë së trajnimit. Edhe pse shumica e personelit nuk kanë qenë në trajnimin e specializuar për integritet, nevoja për edukim dhe trajnim kundër korrupsionit si instrument kyç në mbrojtjen e integritetit është përvetësuar mirë brenda organizatës.

3.2.1.

Sigurimi që zyrtarët ekzistues me role menaxhuese kanë shkathhtësitë e duhura në kuptimin e funksionit dhe detyrave të mbikëqyrjes efektive dhe menaxhimit të rrezikut të integritetit duke ndërmarrë veprime për të ngritur/ fuqizuar dhe vlerësuar periodikisht efektshmërinë e këtyre veprimeve. Ofrimi i trajnimeve adekuate për menaxhmentin e lartë dhe të mesëm për planifikimin e integritetit dhe menaxhimin e rrezikut për të siguruar që procesi i menaxhimit të integritetit në Komunë ka resurset e duhura.

3.2.2.

Mundësimi i qasjes strategjike në zhvillimin profesional duke planifikuar dhe ofruar trajnime bazuar në nevojat faktike. Sigurimi që nevojat e personelit për trajnim sa i përket çështjeve lidhur me integritetin dhe menaxhimin e rrezikut, vlerësohen në mënyrë periodike përmes përdorimit të qasjes së strukturuar dhe që ato dokumentohen mirë në raporte dhe plane trajnimi. Sigurimi që këto raportohen periodikisht tek KIPA, si dhe tek palët tjera përgjegjëse të interesit.

3.2.3. Fuqizimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit për të siguruar që i gjithë personeli është njoftuar mirë dhe me kohë për mundësitë për trajnime. Për këtë qëllim, marrja në konsideratë e futjes së procedurës së strukturuar me rregulla të qarta për transparencë, kontrolle, përgjegjësi dhe mekanizma raportues.

3.2.4. Mundësimi i sistemit të përshtatshëm për monitorimin e shqetësimeve lidhur me trajnime, duke përfshirë përzgjedhjen e personave që do të marrin pjesë në trajnime dhe vizita studimore. Analizimi i trendeve dhe raportimi i tyre tek menaxhmenti i lartë përgjegjës.

3.2.5. Sigurimi i trajnimeve të duhura profesionale për personelin që punon në Departamentin e Personelit. Përdorimi i resurseve të jashtme në dispozicion (d.m.th. KIPA, trajnimin e bazuar në projekte) për të zgjeruar mundësitë.

3.2.6. Zhvillimi dhe ofrimi i programit për ndërgjegjësim dhe edukim për kodin e mirësjelljes dhe atë të etikës. Ofrimi i trajnimit në fillim të punës dhe trajnim periodik të të gjithë punëtorëve lidhur me vlerat në organizatë dhe kodin e etikës, si dhe për mekanizmat për parandalimin e integritetit. Ky trajnim do të duhej të mbulonte në mënyrë eksplicite pritjet e të gjithë punëtorëve lidhur me (1) detyrën e tyre për të komunikuar çështjet e caktuara; (2) listën e llojeve të çështjeve, duke përfshirë shkeljet faktike apo të dyshuara të integritetit, që duhen komunikuar së bashku me shembuj specifik; dhe (3) informatat se si

të komunikohen ato çështje.

3.2.7. Aranzhimi i punëtorive për të edukuar personelin dhe për të krijuar ndërgjegjësim për integritetin dhe korrupsionin, si dhe për të theksuar pritjet përkatëse të udhëheqësisë komunale në lidhje me mirësjelljen e tyre etike.

3.2.8. Përfshirja e aspekteve relevante të Kodit të Etikës në prezantimet e mëtejme të ndërgjegjësit, seancat trajnuese dhe programet komunikuese për të nxitur ndërgjegjësimin tek palët e jashtme dhe të brendshme të interesit.

3.2.9. Prezantimi i rregullt i rasteve studimore dhe dilemave etike për t'iu ndihmuar punëtorëve që të kuptojnë specifikat e korrupsioni dhe për të inkurajuar sjelljet etike.

3.2.10. Mundësimi i raportimit të rregullt për trajnimet e kryera, me analizë të trendeve. Vendosija e strategjive të vlerësimit për të matur efikasitetin e edukimit të personelit dhe trajnimit për ndërgjegjësim në lidhje me korrupsionin dhe menaxhimin e rrezikut. Komunikimi dhe publikimi i rezultateve, siç është e përshtatshme.

3.2.11. Vlerësimi i kulturës së integritetit përmes anketave të synuara për personelin. Raportimi për trendet në lidhje me një varg çështjesh që i mundësojnë menaxhmentit të lartë që të zbulojë zhvillimet negative në mënyrë të mund të ndërmerren veprimet e duhura.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4:

Rregullimi i mjedisit: avancimi i mjedisit të jashtëm për të përforcuar dhe zgjeruar aspektet e integritetit në proceset e modernizimit dhe reformave me procese të përmirësuara të koordinimit dhe komunikimit, si dhe duke mbajtur nivele të larta të transparencës dhe angazhim të palëve të interesit.

Linjat e aktiviteteve dhe masat përkatëse

4.1. Rritja e angazhimit substancial me qytetarët, shoqërinë civile dhe bizneset për të promovuar përkushtimin kolektiv dhe bashkë-pronësinë në reformat për integritet

Arsyetimi: Komuna e Gjilanit vazhdon të ballafaqohet me sfidën e decentralizimit, kapacitetet adekuate për buxhetim në harmoni me politikat dhe planet e implementimit duhen zhvilluar, në mënyrë që të sigurohet që përcaktimi i prioriteteve dhe ndarja e resurseve financiare reflekton udhëzimin strategjik. Potenciali për përfshirjen domethënëse të palëve të jashtme të interesit si partnerë zhvillimorë duhet përdorur më me efikasitet. Kjo kërkon formimin dhe implementimin e politikave për konsultim dhe komunikim që me efikasitet bashkojnë palët e interesit drejt arritjes me kohë të vendimeve/ zgjidhjeve në të mirë të komunitetit lokal.

4.1.1. Kërkimi për mbajtje të periudhave të konsultimit publik të bëra publike mirë para fillimit të buxhetit të ri, rregulloreve të reja dhe/apo projekteve për zhvillimit ekonomik dhe/apo pas përfundimit të planeve. Për këtë qëllim, miratimi i politikave dhe procedurave mbështetëse të duhura për përfshirjen e palëve kyçe të interesit në punën e komunës. Monitorimi dhe raportimi periodik për implementimin e tyre.

4.1.2. Krijimi i komiteteve teknike të palëve të interesit për tema specifike (arsim, shëndetësi, infrastrukturë, etj.) që kanë role hibride mbikëqyrëse/konsultative. Përfshirja e shoqërisë civile/bizneseve me përfaqësuesit e departamenteve përkatëse komunale dhe ofruesve të shërbimeve. Këto komitete mund të ndërlihen me komunën sipas nevojës, që duke u bazuar në përvojën e tyre të shfrytëzojnë shoqërinë civile për të lehtësuar mbikëqyrjen

publike.

4.1.3. Mbajtja e “Ditëve me dyer të hapura” në zyrat e zyrtarëve komunal të nivelit të lartë, për të avancuar të kuptuarit e publikut për funksionet dhe përgjegjësitë e punës së lidërsipit.

4.1.4. Lehtësimi i implementimit të përbashkët të Forumit për integritet ku zyrtarët, shërbyesit civil dhe OJQ-të bashkëpunojnë dhe krijojnë fushata informative të fokusuara kah qytetarët. Të gjitha palët do të krijojnë fushatë të përbashkët për informimin e qytetarëve, për të siguruar që pushteti komunal dhe shoqëria civile ndajnë të njëjtat informata përmes rrugëve të tyre përkatëse.

4.1.5. Eksplorimi i mundësive për bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Komunave në Kosovë, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe komunat tjera kosovare në fushën e integritetit dhe kundër-korrupsionit,

si dhe mundësive për marrjen e asistencës relevante teknike nga donatorët për të nxitur ngritjen e kapaciteteve dhe për avancuar aktivitetet që lidhen me integritetin. Për këtë qëllim, krijimi i strukturës për bashkëpunim dhe komunikim: pikat e kontaktit, TR, mekanizmat raportues dhe monitorues.

4.1.6. Marrja në konsideratë e sigurimit të linjës hotline kundër korrupsionit për qytetarët dhe bizneset për t'i ofruar komunës kanal të besueshëm ku mund të raportohen shkeljet e integritetit. Granatimi

i sigurisë për përdoruesit, ofrimin me kohë të përgjigjeve adekuate për ankesat dhe integrimin e rezultateve në sistemin e menaxhimit përmes analizës së synuar të dhënave dhe masave përkatëse korrigjuese.

4.1.7. Marrja në konsideratë e përdorimit të medieve sociale për fushatë komunikimi të diversifikuar/rritur.

4.2. Sigurimi fushatës me nivel të lartë të transparencës

Arsyetimi: Niveli i lartë i përkushtimit për transparencë dhe rritja e angazhimit substancial me shoqërinë civile dhe qytetarët; komuna mundet të ndryshojë në thelb dinamikën e marrëdhënieve në mes palëve të interesit dhe të ndihmojë në arritjen e rezultateve të mira nga politikat me kosto më të ulët; përputhshmëri më e rreptë me vendimet e arritura, përgjegjësia e ndarë për ofrimin e shërbimeve dhe roli i ndarë për avancimin e integritetit.

4.2.1. Mundësimi i implementimit rigoroz të udhëzimit të ri administrativ për transparencë në komuna përmes ofrimit të resurseve adekuate për funksionin, alokimin të përgjegjësive dhe monitorimit të vazhdueshëm të implementimit.

4.2.2. I aspekteve të integritetit në strategjinë e jashtme të komunikimit duke shtuar fokusimin në integritet për të bartur mesazhin AC tek të gjitha palët e jashtme të interesit.

4.2.3. Marrja në konsideratë e krijimit të pikave të-gjitha-në-një-vend për publikun – konsolidimi i të gjitha informatave komunale në një vend ku publiku do të priste të gjente ato. Për disa shërbime (për dokumente personale, regjistrim biznesesh), marrja në konsideratë e përpilimit të fletushkave me informata të përgjithshme. Krijimi i sistemit të strukturuar, me kanale të diversifikuara për të informuar vazhdi-

misht qytetarët lidhur me të drejtat e tyre dhe si të realizohen ato të drejta, ofrimin e shërbimeve administrative publike, mënyrat për të pasur qasje në këto shërbime dhe çështjet tjera që mund të jenë në interes të tyre. Marrja në konsideratë e vënies së Tabelës së transparencës ku do të vendoseshin fletushka të ndryshme, rregullore, urdhëresa, lajmërimet, standarde të shërbimeve, udhëzime/modele referimi/ndihmues, etj. që mund të paraqitet në një format që është miqësor për përdoruesit që të mundësojë përdorim të lehtë dhe të duhur.

4.2.4. Puna me departamente komunale, OJQ dhe ekspertë për komunikim dhe media për të identifikuar të dhënat që mbahen nga komuna që mund të bëhen publike për të përmirësuar transparencën dhe për të zvogëluar mundësitë për shkelje të integritetit.

4.2.5. E implementimit adekuat të kërkesave të udhëzimit administrativ për uebfaqet e institucioneve dhe krijimi i sistemit për monitorimin e implementimit të tij dhe përditësimin të rregullt. Atëherë kur është e përshtatshme dhe e realizueshme, publikimi i informatave lidhur me fushat kryesore të funksionimit të komunës: ligjet/rregulloret relevante; Kodi i Mirësjelljes, raportet vjetore të menaxhmentit; “raportet e buxhetit lehtë të kuptueshme” që paraqesin pasqyrë të thjeshtë të operimeve financiare; prokurimin; rekrutimin dhe vendet e lira të punës; aktivitetet dhe vendimet e marra nga kuvendi komunal. Marrja në

konsideratë e përfshirjes së informatave relevante në lidhje me avancimin e politikave/masave/arritjeve të integritetit të Komunës, d.m.th. Deklarata e Integritetit, Planin e Integritetit dhe raportet për implementimin e tyre.

4.2.6. Nëse është e nevojshme, ofrimi i trajnimeve për shkathtësi në TI të nevojshme për mbajtjen e transparencës miqësore për përdoruesin në ueb.

4.3. Mundësimi i mjedisit për të mundësuar qasje të lirë në informata publike

4.3.1. E drejta e qasjes në dokumente publike është instrument kyç për të siguruar transparencë dhe për të rritur llogaridhënie. Zhvillimi/mbajtja e kornizës së brendshme të duhur për të siguruar që palët e interesit kanë qasje të lirë dhe të lehtë në informatat publike, përtej mjedisit kombëtar rregullativ. Për këtë qëllim, marrja në konsideratë e miratimit të procedurës/rregullave të synuar të brendshme për procedimin e aplikacioneve për qasje në informata publike; formularët, vendet për dhënin e informatave publike dhe kostot e ndërlidhura.

4.3.2.

Krijimi i bazës së të dhënave me kërkesat për qasje në dokumentet dhe infor-

matat publike për të mundësuar përcjellje efikase të auditimit.

4.3.3.

Trajnimi i personelit për dispozitat ligjore dhe kërkesat procedurale.

4.3.4.

Monitorimi dhe implementimi i lejeve për t’iu qasur dokumenteve publike. Ofrimi i monitorimit adekuat dhe profesional i implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike nga komuna. Ndërmarrja e menjëhershme e masave korrigjuese në rastet kur raportohen/identifikohen mangësi.

PLANI I VEPRIMIT

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Veprimi/Masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati i fundit për implementim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit
---------------	--------------------	---	--------------------------------	------------------------	--

Veprimet/ masat për të përkrahur implementimin e objektivave	Indikatorët që shërbejnë për verifikimin e implementimit të veprimit	Koha e pritur për të përfunduar implementimin e veprimit të caktuar	Njësitë për të koordinuar implementimin dhe institucionet/ organizatat që hyjnë në partneritet	Komuna e Gjilanit – përgjegjëse për implementimin e masës së caktuar	Veprimet/ masat për të përkrahur implementimin e objektivave
--	--	---	--	--	--

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Rregullimi i qeverisjes: fuqizimi i kornizës së politikave dhe institucionale për menaxhim efikas të rrezikut të integritetit;

Veprimi/Masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati i fundit për implementim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Rregullimi i praktikave të menaxhimit të rrezikut: avancimi i kontrolleve operative për fushat specifike të operimit me rrezikshmëri të lartë

Veprimi/Masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati i fundit për implementim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Rregullimi i resurseve: sigurimi i kapaciteteve adekuate të personelit për të udhëhequr, implementuar, monitoruar dhe përforcuar reformat e integritetit

Veprimi/Masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati i fundit për implementim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Rregullimi i resurseve: sigurimi i kapaciteteve adekuate të personelit për të udhëhequr, implementuar, monitoruar dhe përforcuar reformat e integritetit

Veprimi/Masat	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese/ palët partnere të interesit	Afati i fundit për implementim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit



Nëntor 2015